



KURTI: ÇDO DITË PO ANGAZHHEMI QË MASAVE TË PADREJTA TË BE-së NDAJ KOSOVËS T'U VIJË FUNDI

FAQE 4-5



Kryeministri Albin Kurti ka mbajtur mbledhjen e parë të rregullt të kabinetit qeveritar për vitin 2024. Ai të mërkurën u ka thënë ministrave se po hyjnë në një vit të ri me shumë

punë përpara vetes. Në hapjen e mbledhjes së qeverisë, Kurti ka përmendur masat ndëshkuese të Bashkimit Evropian të cilat i ka quajtur të padrejta, ashtu siç ka thënë se

ishte regjimi i vizave deri në fillim të këtij viti. Kryeministri ka thënë se qeveria po angazhohet çdo ditë që masave të padrejta të BE-së ndaj Kosovës t'u vijë fundi

KOSOVA MUND TË NDODHET NË VIJËN FRONTALE TË KONFLIKTIT RUSI - NATO

F. 6-7

Shkruan:
Hajdin ABAZI



EDHE DY JAVË AFAT PËR MBLEDHJEN E NËNSHKRIMEVE PËR SHKARKIMIN E KRYETARËVE NË VERI

F. 3



KRIZA ENERGETIKE, QEVERIA NDAN 16 MILIONË EURO

F. 8

SPORT



KOZNIKU: PO TË ISHA MENAXHER ÇDO DITË DO TA MBUSHJA NGA NJË AUTOBUS ME TALENTË NGA KOSOVA

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princsha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjykatësit shprehin skepticizëm se Trumpi është imun ndaj ndjekjes penale

UASHINGTON, 10 JANAR - Gjykatësit e Gjykatës së Apelit të Shteteve të Bashkuara kanë shprehur dyshimet e tyre se ish-presidenti amerikan Donald Trump është imun ndaj ndjekjes gjyqësore në nën akuzat se kishte tentuar ta përmbyste rezultatin e zgjedhjeve presidenciale të vitit 2020. Në një rast historik, avokatët e Trumpit thanë se koha që ai e ka kaluar në pushtet e mbron atë nga akuzat në lidhje me dyshimet se u përpoq ta zhbënte disfatën në zgjedhjet presidenciale 2020. Por, Departamenti i Drejtësisë argumentoi se Presidenca nuk është mbi ligjin. Gjatë seancës së gjatë dëgjimore, gjykatësit i bënë trysni vazhdimisht avokatit të

Trumpit që t'i mbrojë pretendimet se Trumpi është i mbrojtur nga akuzat penale për veprimet të cilat ai thotë se ishin pjesë e detyrave të tij si president. Trump, 77 vjeç, thotë se ai nuk duhet të përballet me akuza penale sepse në atë kohë kishte vepruar si president. Ai vazhdimisht e ka përmendur imunitetin presidencial derisa është përballur me raste penale dhe civile. Ky argument i tij u rrëzua muajin e kaluar nga një gjykatës i një gjykate më të ulët, i cili po merret me rastin kundër tij, ndërsa edhe gjykatësit e Apelit shprehën dyshimet e tyre se presidentët gëzojnë imunitet të plotë pasi të jenë larguar nga zyra e

presidentit. Pavarësisht vendimit që do ta marrë Gjykata e Apelit, rasti pritet të përfundojë në Gjykatën Supreme të ShBA-së, ku konservatorët kanë shumicën prej 6-3. Ky rast mund të ketë ndikim të madh në të ardhmen e presidencës amerikane dhe për atë se çfarë i lejohet një presidenti. Trumpi është favorit në garën për t'u nominuar kandidat për president nga radhët e republikanëve dhe pritet të garojë kundër presidentit Joe Biden në zgjedhjet e nëntorit. Trumpi tha pasi doli nga gjykata se nuk ka bërë asgjë të gabuar dhe se po ndiqet penalisht për "arsyeje politike". "Presidenti duhet të ketë imunitet", tha ai.



Blinken: ShBA-ja mbështet hapa konkretë për një shtet palestinez

UASHINGTON, 10 JANAR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, i tha presidentit të Autoritetit Palestinez, Mahmoud Abbas, se Uashingtoni mbështet "hapa konkretë" drejt krijimit të një shteti palestinez. Blinken i përsëriti qëndrimin e kamotshëm të Uashingtonit se një shtet palestinez duhet të ekzistojë përkrah Izraelit, "duke jetuar të dy në paqe dhe siguri", tha zëdhënësi i Departamentit amerikan të Shtetit, Matthew Miller, në një deklaratë. Krijimi i një shteti palestinez pritej të ndodhte pas Akordeve të Oslos në vitet '90, por bisedimet kanë ngecur për vite të tëra. Qeveria izraelite nuk ka shfaqur interes për ringjalljen e negociatave dhe udhëheqja



palestineze vazhdon të jetë e ndarë midis Autoritetit Palestinez, që udhëhiqet nga Abbasi, dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian - që udhëheq

Ripin e Gazës. Abbasi e përshkroi Ripin e Gazës si "pjesë integrale e shtetit palestinez", sipas agjencisë zyrtare të lajmeve palestineze, "Wafa". "Nuk është e mundur të pranohet apo të merren me

planet e autoriteteve pushtuese për ta ndarë atë, apo për të shkëputur pjesë të tij", i tha lideri palestinez kryediplomatit amerikan. Për javë të tëra po zhvillohen diskutime lidhur me atë se si do të qeveriset Gaza pasi të përfundojë lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit që nisi më 7 tetor. Izraeli ka paralajmëruar se luftimet ka gjasa të vazhdojnë për muaj. Abbasi gjatë takimit në Bregun e pushtuar Perëndimor me Blinkenin e ngriti edhe çështjen e "përpjekjeve të bëra për ta ndaluar agresionin izraelit kundër popullit palestinez në Ripin e Gazës dhe Bregun Perëndimor", raportoi Wafa. Lufta e fundit në mes të Izraelit dhe Hamasit nisi më 7 tetor, pasi

radikalët palestinezë sulmuan jugun e Izraelit duke vrarë 1 200 persona dhe marrë peng 240 të tjerë. Izraeli u kundërpërgjigj me sulme ajrore, tokësore dhe detare që lënë të vdekur mbi 23 000 palestinezë në Rripin e Gazës. Blinken ditët e fundit ka qëndruar në disa shtete në rajon, përfshirë edhe në Izrael. Më 9 janar Blinken deklaroi në Tel Aviv se Izraeli duhet të ndërmarrë hapa më të mëdhenj për t'i mbrojtur civilët, për ta lejuar dërgimin e më shumë ndihma e në Gazë dhe i bëri thirrje të punojë me udhëheqësit e moderuar palestinezë. Ai tha se shtetet rajonale do të investojnë në rindërtimin e Gazës vetëm nëse do të ketë "një rrugë që do të çojë drejt një shteti palestinez".

OKB: Dyzet për qind e ukrainasve do të kenë nevojë për ndihmë humanitare këtë vit

NJU-JORK, 10 JANAR - Më shumë se 14.6 milionë ukrainas brenda vendit apo rreth 40 për qind e popullsisë së përgjithshme do të kenë nevojë për ndihmë humanitare gjatë këtij viti, sepse lufta pushtuese e Rusisë në Ukrainë po vazhdon të shkaktojë vdekje dhe shkatërrim, tha Zyra e OKB-së për Koordinim të Çështjeve Humanitare (KCH). Gjendja e tanishme humanitare ka shumë mundësi të përkeqësohet më shumë këtë vit nëse luftimet vazhdojnë dhe nëse rriten sulmet ndaj energjisë dhe infrastrukturave të tjera të

rëndësishme, tha KCH më 9 janar. Sipas saj, lufta i ka detyruar rreth 6.3 milionë ukrainas të strehohen jashtë vendit, dhe në fund të këtij viti, 5.9 milionë refugjatë nga Ukraina u regjistruan në Evropë. "Civilët po vriten dhe plagosen çdo ditë, ndërsa shtëpitë e tyre dhe infrastruktura e rëndësishme po shkatërrohen", tha KCH. Rusia i sulmoi rajonet e Ukrainës me një breshër raketash nga ajri më 8 janar, duke i vrarë së paku katër persona, plagosur mbi 40, si dhe duke shkaktuar dëme në infrastrukturën civile dhe

objektet ekonomike. Ushtria ukrainase tha se në shumicën e vendit, përfshirë në kryeqytetin Kiev, u lëshuan sirena për sulme ajrore më 8 janar. "Java e parë e janarit solli një valë sulmesh në Ukrainë, duke nisur nga 29 dhjetori deri më sot", shtoi ajo. Misioni i Kombeve të Bashkuara në Ukrainë i bëri thirrje komunitetit ndërkombëtar të bëjë më shumë për ta ndihmuar Ukrainën dhe fqinjëve për t'u ballafaquar me nevojat e vazhdueshme të popullsisë civile gjatë sezonit të dimrit.



Limaj: Kurti po shkon drejt krijimit të një diktature

PRISHTINË, 10 JANAR - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se Albin Kurti si kryeministër është duke shkuar në mënyrë të sigurt drejt rrënimin të krejt asaj që është bërë deri tani pozitivisht në vend. Sipas tij, askush më mirë se Kurti nuk do të bënte përpjekje për ta

shkatërruar këtë vend. “Albin Kurti është duke shkuar në hapa të sigurt të krijimit të një diktature autoritative të rrënimin të krejt asaj që është ndërtuar në këtë vend. Po na kthen njëfarë regjimi që ky popull shumë shpejt ka për ta parë, duke tentuar që t’i fusë në dorë të gjitha. Një

njëri që përfundimisht do të na fusë në atë logjikën neokomuniste të kontrollimit të çdo gjeje në këtë vend”, ka thënë Limaj në emisionin “Gallatë” në “Kanal10”. Limaj ka shprehur kritika për kryeministrin Kurti edhe për situatën në veri të Kosovës.

Sipas tij, ajo pjesë e territorit të Kosovës është më keq se asnjëherë më parë. “Qysh bre është duke bërë mirë me veriu, a janë kah ju shohin sytë? Çka ka në veri sot? Krejt janë aty, vetëm e kanë urdhrin e Vuçiqit me hesht. Asgjë nuk ka ndryshuar. Do të shohim udhës. Dhe kjo çka



po ndodh, ky është shqetësimi im”, ka thënë Limaj.

Nagavci thotë se mësimdhënësit do t’i nënshtrohen testimit, i reagon Jasharaj: Kurrë s’do të ketë test

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**
PRISHTINË, 10 JANAR - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka thënë se është e bindur që mësimdhënësit do të aplikojnë për t’u pajisur me licencë të avancuar, që nënkupton nënshttrimin e testit me shkrim. Nagavci në eventin përmbyllës të Projektit QATEK, i cili ka për qëllim fillimin e një sistemi për përgatitjen e mësimdhënësve të rinj të orientuar në cilësi, ka thënë se duhet të punohet për përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. “Synojmë që nga qershori i këtij viti do të nisemi edhe për prodhimin për licencë të avancuar për mësimdhënësit sipas kriterëve që janë përcaktuar mbi bazën e standardeve profesionale dhe jam e bindur që kemi mësimdhënësit që janë të gatshëm të aplikojnë për këtë licencë”, u shpreh Nagavci. Në lidhje me këtë deklaratë të Nagavcit ka reaguar kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK),

Rahman Jasharaj. Ai ka thënë se sa të ketë SBASHK nuk do të ketë test me shkrim për njohuritë e mësimdhënësve. “Shumë herë e kam ngritur zërin në mbrojtje të punëtorëve të arsimit, sepse e kam ndier për borxh edhe ndaj atyre më të cilët e kemi mbrojtur arsimin shqip në vitet ‘90. Kam thënë, duke u bazuar në zërin e anëtarësisë, se ka greva. Kam deklaruar se kurrë, sa të ketë SBASHK, nuk do të ketë test me shkrim për njohuritë e mësimdhënësve”, ka thënë Jasharaj. Ai ka treguar se ka kërkuar publikisht tani e sa muaj takime me ministren Nagavci për t’i shpalosur kërkesat e punëtorëve të arsimit por, sipas tij, ajo e mban e vazhdon ta mbajë inatin për grevën dhe nuk pranon takime. “Punëtorët e arsimit duhet të dinë edhe ca të vërteta të tjera nga ‘miqësia’ për ta e ministres Nagavci”, është shprehur kryetari i SBASHK-ut. Jasharaj ka theksuar se punëtorët e arsimit duhet ta dinë se ministria Nagavci nuk është zëri i tyre në qeveri. “Punëtorët e



arsimit duhet ta dinë se ministria nuk është zëri i tyre në qeveri edhe pse SBASHK-u e kishte lutur vazhdimisht që ta bënte këtë. Ministria Nagavci, duke parë se në Këshillin Shtetëror për Licencim nuk mund t’i kalojë planet e saj kundër mësuesve të Kosovës pa u bërë publike e pa u zhvilluar debate, udhëzoi bashkëpunëtorët e saj dhe do të tjerë dhe e hoqën

nga përbërja e Këshillit Shtetëror të Licencimit të Mësimdhënësve përfaqësuesin e vetëm të tyre, pra SBASHK-un . E pse? Për të bërë eksperimente e për të vendosur çdo gjë kundër punëtorëve të arsimit e pa pasur kush të kundërshtojë e t’i bëjë publike këto angazhime të saj”, ka thënë Jasharaj. Jasharaj ka thënë se ministria

Nagavci po vendos pa përfaqësues të SBASHK-ut, të prindërve, të kolegjiut të drejtorëve, të Asociacionit të Komunave. “Kujdes! Duam avancim, por me marrëveshje dhe pa degradim e nënçmim të të gjitha arritjeve tona në gjithë ato vite të studimeve”, është shprehur kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj.

Shtatë persona të prekur me grip të derrit, një me Covid-19



PRISHTINË, 10 JANAR - Shtatë pacientë me influenza të grupit të derrit (AH1N1) dhe një me Covid-19 janë duke u trajtuar në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Lajmin për “Albanian Post” e ka konfirmuar drejtori i Klinikës Infektive, Arben Vishaj, i cili ka theksuar se “gjendja e tyre është stabile”. “E kemi një pacient i cili është duke u trajtuar në Mjekimin Intensiv nga AH1N1 dhe është me parametra klinike laboratorike stabile”, ka thënë Vishaj. Ai ka sqaruar se numri i pacientëve që janë duke ardhur në

këtë periudhë kohore është mjaft i madh. “Kemi vërejtur një fluks të madh të pacientëve në këtë periudhë kohore në ambulancën e pranimit me simptomatologji të virozëve të traktit respirator, por kërkesa për spitalizim nuk është e madhe”, ka deklaruar Vishaj. Para tre muajsh komuna e Prishtinës kishte njoftuar se 14 Qendra të Mjekësisë Familjare në kryeqytet janë furnizuar me vaksinën kundër gripit sezonal. Sipas njoftimit, në administrim kryeqyteti kishte pasur 6 mijë e 700 doza të kësaj vaksine dhe qytetarët mund të vaksinoheshin

çdo ditë pune. “Të dashur qytetarë, ju ftojmë të vaksinoheni, sidomos të moshuarit, personat me sëmundje kronike, fëmijët nën moshën pesë vjeçe dhe gratë shtatzëna”, thuhet në komunikatën për medie. Vaksinimi kundër gripit sezonal në Kosovë ka nisur në muajin tetor. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës kishte njoftuar se fillimisht duhet të vaksinohen personat e moshës mbi 65 vjeç, personat me sëmundje kronike, gratë shtatzëna dhe fëmijët mbi 6 muaj me imunitet të dobësuar.

Aktakuzë ndaj 27 personave në Kosovë për kontrabandim të migrantëve

PRISHTINË, 10 JANAR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj 27 personave për shkak se ishin marrë me kontrabandim të migrantëve. Sipas njoftimit, të 27 të pandehurit kishin

bashkëpunuar për të kontrabanduar më shumë se 700 persona, kryesisht sirianë, nga Shqipëria për në Kosovë. Më pas, sipas Prokurorisë Speciale, të pandehurit u kishin mundësuar migrantëve

kalimin e tyre në Serbi, pasi ata synonin shkuarjen në shtetet evropiane. Që nga viti 2015 shtetet e Ballkanit Perëndimor janë shndërruar në qendër transiti për personat që ikin nga Lindja

e Mesme dhe Afrika dhe që synojnë të arrijnë në shtetet e Bashkimit Evropian. Kosova ka qendra për pranimin e emigrantëve, por shumica e tyre e përdorin këtë shtet si transit për në BE.





Kurti: Çdo ditë po angazhohemi që masave të padrejta të BE-së ndaj Kosovës t'u vijë fundi

Kryeministri Albin Kurti ka mbajtur mbledhjen e parë të rregullt të kabinetit qeveritar për vitin 2024. Ai të mërkurën u ka thënë ministrave se po hyjnë në një vit të ri me shumë punë përpara vetes. Në hapjen e mbledhjes së qeverisë, Kurti ka përmendur masat ndëshkuese të Bashkimit Evropian të cilat i ka quajtur të padrejta, ashtu siç ka thënë se ishte regjimi i vizave deri në fillim të këtij viti. Kryeministri ka thënë se qeveria po angazhohet çdo ditë që masave të padrejta të BE-së ndaj Kosovës t'u vijë fundi

EPOKA E RE**Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 10 JANAR - Kryeministri Albin Kurti ka thënë se qeveria e tij është duke bërë angazhim çdo ditë që masave të padrejta të vendosura nga Bashkimi Evropian t'u vijë fundi. “Derisa angazhohemi çdo ditë që masave të padrejta të Bashkimit Evropian ndaj Kosovës t'u vijë fundi, jemi shumë të lumtur që në këtë fillimvit i erdhi fundi masës më të padrejtë e më të gjatë që Bashkimi Evropian praktikisht kishte mbi qytetarët e Republikës sonë, regjimin e vizave. Kemi qenë shteti i fundit dhe i vetëm në Ballkan dhe Evropë që nuk ka mundur të lëvizë lirshëm përtej shteteve fqinje. Ai regjim, përkundër urimeve e festave, premtimeve e compromiseve,

megjithatë i përshkoi të gjitha qeveritë pararendëse. Përfundimit të kësaj epoke duhet t'i gëzohemi që të gjithë. Fitoret, sukseset dhe arritjet e këtij muaji së pari janë të shtetit të Kosovës, nga të cilat përfitojnë qytetarët e vendit tonë para së gjithash e mbi të gjitha e që, në fakt, njëkohësisht janë edhe më meritoret”, ka thënë Kurti në mbledhjen e qeverisë të mërkurën. Kurti ka thënë se pavarësisht prej ndryshimeve përparimtare për vendin tonë, edhe ky vit po na e trashëgon një fqinj të vjetër i cili po përkeqësohet. “Javën e kaluar dy qytetarë të Republikës së Kosovës, Hasan dhe Xhavit Dakaj, u ndaluan dhe u arrestuan në kufi me Serbinë. Hasan Dakaj edhe sot vazhdon të mbahet atje padrejtësisht dhe në mënyrë arbitrare. Kjo nuk është hera e

parë dhe as nuk paraqet një rast të izoluar. Kjo është sjellje e qëllimshme dashakeqe e Serbisë, që bie ndesh me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”, është shprehur Kurti. Ai ka shtuar se Serbia vazhdon të mbajë në paraburgim edhe një qytetar tjetër të Republikës së Kosovës, Nezir Mehmetaj. Kurti ka thënë se Nezir Mehmetaj ka qëndruar me muaj të tërë në paraburgim pa aktakuzë, në kundërshtim edhe me ligjet e Serbisë, të gjetura këto që i ka theksuar edhe Fondi për të Drejtën Humanitare në Serbi. “Më 27 shkurt 2023 përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë, Josep Borrell, ka deklaruar se marrëveshja bazike ndërmjet dy palëve, Kosovës dhe Serbisë, ishte arritur. Kjo marrëveshje udhëzohet nga parimet e mbrojtura me Konventën e Kombeve të Bashkuara, në veçanti ato të respektimit të pavarësisë dhe integritetit territorial, të së drejtës për vetëvendosje, mbrojtjes dhe të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimit. E posaçërisht, në nenin 1 të Marrëveshjes, pra qysh në fillim të saj, theksohet se palët, domethënë Kosova dhe Serbia, do të zhvillojnë marrëdhënie të mira fqinjësore me njëra-tjetrën bazuar në të

drejta të barabarta”, ka thënë Kurti. Sipas tij, Serbia, megjithëkëtë, zgjedh pothuajse çdo gjë mbi zhvillimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore me Kosovën. “Ajo, në të vërtetë, zgjedh ta sulmojë Kosovën ashtu siç ka bërë me datën 24 shtator 2023 në Banjskë të Zveçanit, pastaj t'i mbrojë nga burgimi kryerësit e kësaj veprë terroriste në krye me Millan Radojçiqin. Serbia nuk është rrezik siç shihet e dihet vetëm për qytetarët tanë, sigurinë tonë, stabilitetin rajonal në Ballkan. Ajo së fundmi ka dëshmuar se paraqet rrezik edhe për qytetarët e saj, sidomos ndaj atyre që kanë guximin të pranojnë se përmes kërkim-faljes për gjenocidin e Serbisë në Kosovë, ndërtojnë bazë të zhvillimit të marrëdhënieve të mira paqësore e të pajtimit”, ka thënë ai, duke shtuar se kështu është rasti me liderin opozitar serb, Nikolla Sandulloviq, kryetar i Partisë Republikane atje, për të cilin, krahas torturave fizike ndaj tij, shteti serb zgjedh të ngrehë aktakuzë për nxitje të urrejtjes kombëtare, sepse ai u përku për varrit të shtatë vjeçes Blerina Jashari, e vrarë nga forcat serbe në Prekaz, në marsin e vitit 1998. “Trajtimi i Nikolla Sandulloviqit nga Agjencia e Sigurisë dhe Informacionit e Serbisë flet për

mendësinë të cilën fqinji ynë e kultivon brenda vetes. Mënyrat, sjelljet dhe veprimet antidemokratike pasqyrojnë realitetin e hidhur atje, vendin ku nuk njihet fjala e lirë, nuk vlejnë konventat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të pakicave, e ku me frikë dhe dhunë tentohet të mposhtet opozitarizmi dhe çdo zë që i kundërvihet pushtetit autokratik të Aleksandër Vuçiqit. Serbia është vendi ku Millan Radojçiqi, përgjegjës për sulmin terrorist në Banjskë, në vend se të përgjigjet para autoriteteve të rendit, merr pjesë në rrahjen brutale të Nikolla Sandulloviqit”, ka theksuar Kurti. Ai ka shtuar se e përcjellë në dritën e shkeljeve të të drejtave të njeriut e çdo zëri opozitar e paqësor, Serbia vazhdon rrugëtimin drejt metodave të Putinit nga frikësimi e deri te torturimi çnjerëzor i kundërshtarëve politikë. “Në drejtim të kundërt me obligimet në kuadër të Marrëveshjes bazike për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve tona, ata gjithnjë e më larg vlerave të Bashkimit Evropian dhe të integritetit evropian e euroatlantik, të cilin edhe në teori e pretendojnë gjithnjë e më pak”, ka pohuar kryeministri Kurti.

Edhe dy javë afat për mbledhjen e nënshkrimeve për shkarkimin e kryetarëve në veri

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 JANAR - Qytetarët e komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq dhe Zubin Potok, kanë edhe 12 ditë kohë për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë në komunat e tyre përkatëse, ka njoftuar ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës, Elbert Krasniqi.

Në komunën tjetër veriore, Zveçan, mbledhja e nënshkrimeve nisi më vonë, tha ai, pa treguar kur saktësisht. Kryetarët shqiptarë u vendosën në zyrat e tyre në katër komunat me shumicë serbe pas zgjedhjeve të kundërshtuara dhe bojkotuara nga serbët lokalë në prill të vitit të kaluar, duke nxitur

Hapat drejt zgjedhjeve sipas udhëzimit

Udhëzimi administrativ për largim të kryetarit të komunës, i lëshuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, i parasheh këta hapa: Kërkesa duhet të bëhet nga i ashtuquajti grup nismëtar, i cili përbëhet nga tre apo më shumë persona me të drejtë vote në komunën përkatëse. Ky grup e njofton kryesuesin e Kuvendit Komunal për kërkesën në fjalë dhe pajisjet me dokumentacionin e nevojshëm. Më pas, grupit i duhet të mbledhë një minimum prej 20-përqindësh të nënshkrimeve të qytetarëve me të drejtë vote, me

kërkesë për largim të kryetarit. Lista me nënshkrime duhet dërguar kryesuesit të Kuvendit Komunal, e cila më vonë përfundon në Komisionin Qendror Zgjedhor. Nëse KQZ-ja vlerëson se kushtet janë përmbushur, organizohen zgjedhjet për largimin e kryetarit. Nëse në ato zgjedhje sigurohen 50 për qind plus 1 votë për largim të kryetarit, ai largohet prej funksionit dhe organizohen zgjedhje të reja. Në rast të kundërt, iniciativa dështon. Ajo do të mund të përsëritet vetëm pas një viti. Duke u bazuar në listën

përfundimtare të votuesve për zgjedhjet e prillit, i bie që, për ta çuar peticionin përpara, në Mitrovicë të Veriut duhen 3 600 nënshkrime, në Leposaviq 2 600 nënshkrime, në Zveçan 1 400 nënshkrime dhe në Zubin Potok 1 300 nënshkrime. Sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, zgjedhjet e parakohshme për kryetarë mund të mbahen në tri raste: nëse kryetari aktual jep dorëheqje; nëse qytetarët kërkojnë shkarkimin e tij përmes peticionit; dhe nëse kryetari i komunës nuk paraqitet në vendin e punës më shumë se një muaj pa arsye.

komunave të tyre përkatëse përmes peticionit. “Dje kemi pasur takim me diplomatët e Quintit dhe të BE-së për këtë çështje. Tashmë qytetarët në veri të vendit në dhjetor kanë nisur kërkesën e tyre të parë dhe janë në proces të mbledhjes së nënshkrimeve. Kemi katër grupe të qytetarëve në veri të vendit që janë autorizuar për mbledhjen e nënshkrimeve”, ka thënë Krasniqi të mërkurën.

Ai ka theksuar se qytetarët në Mitrovicë të Veriut, Leposaviq dhe Zubin Potok e nisën mbledhjen e nënshkrimeve më 22 dhjetor dhe, sipas udhëzimit administrativ, ata kanë kohë deri më 22 janar për t'i mbledhur 20 për qind të nënshkrimeve të trupës votuese në komunat e tyre përkatëse për të qenë i mundur shkarkimi i kryetarit komunal.

rritje të tensioneve në atë pjesë të vendit. Ndërkohë, Kosova përpiloi

një udhëzim administrativ, i cili u mundësoi qytetarëve të këtyre

komunave ta kërkojnë shkarkimin e kryetarëve të

PDK-ja: Është i papranueshëm çfarëdolloj statuti i Asociacionit që bie ndesh me Kushtetutën

PRISHTINË, 9 JANAR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka zhvilluar takime të ndara me kryesinë e partisë dhe me kolegjiun e kryetarëve të degëve, në të cilat ka diskutuar për zhvillimet aktuale politike në vend.

Krasniqi është shprehur se viti 2023 ishte vit i humbur për Kosovën, i cili u karakterizua me degradim në arsim, kolaps në shëndetësi, stagnim ekonomik, shpërpullim dhe migrim masiv, diplomaci të dështuar dhe me sanksione nga Bashkimi Evropian si rezultat i

keqqeverisjes dhe paaftësisë së qeverisë Kurti. Kryesia e PDK-së ka diskutuar edhe për draft-statutin e Asociacionit. U tha se ky draft krijon një nivel të ri të pushtetit në Kosovë, pasi ka kompetenca të qarta ekzekutive. Krasniqi ripërsëriti qëndrimin se për PDK-në është i papranueshëm çfarëdolloj statuti i cili e parasheh formimin e Asociacionit me kompetenca që bie ndesh me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës, krijon një nivel të ri të pushtetit dhe ka kompetenca ekzekutive. Në fund të këtyre takimeve,

Krasniqi njoftoi kryesinë dhe kryetarët e degëve të PDK-së për hapat e ardhshëm të opozitbërjes dhe kërkoi përkushtimin e tyre për implementimin e vizionit të partisë. Krasniqi tha se Kosova ka nevojë për një qeveri kredibile, të aftë dhe të përgjegjshme, e cila, krahas punës për përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve, rikthen vendin në kursin e duhur të integritetit euroatlantik. Kryesia dhe kryetarët e degëve të PDK-së shprehën gatishmërinë dhe përkushtimin e tyre për t'u angazhuar për mobilizimin e PDK-së në të gjithë vendin.



Kosova mund të ndodhet në vijën frontale të konfliktit Rusi - NATO



Shkruan: Hajdin ABAZI

Për të gjithë vëzhguesit e vëmendshëm, sidomos për ata që përcjellin kahet e trendëve midis superfuqive, se si ndizen vatrat e krizave dhe luftërave lokale në funksion të gjeopolitikave, nuk mundet t'u shpëtojnë nga vëmendja zhvillimet në Ballkanin Perëndimor në dekadat e kaluara, me theks të veçantë këto të dy viteve të fundit dhe të këtyre ditëve, dhe rreziqet që ato ekspozojnë. Faktorët dhe rrethanat janë mjaft sinjifikative.

Lufta agresore e Rusisë në Ukrainë, si dhe rezistenca mbrojtëse e kësaj të fundit, po vazhdojnë thua me intensitet të njëjtë. Rusia është strategjikisht e interesuar për të hapur konflikte të tjera, në anët të ndryshme të globit, e sidomos në ato vatra ku ka probleme të akumuluar si, p. sh., raportet Palestinë - Izrael, por edhe raportet serbe me shqiptarët, boshnjakët, malazezët dhe maqedonasit.

Në Ballkan politika shoviniste serbe, që në substancë ka ekspansionin dhe pushtimin e popujve të tjerë, është një vëllam gjenetik i gjeopolitikës së Rusisë. Ajo edhe ashtu ka krijuar lidhje të ndryshme ushtarake, ekonomike e të strukturave të ndryshme me Rusinë, por edhe me Kinën që ka shqetësuar Bashkimin Evropian (BE) dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Vitet e fundit është armatosur aq shumë me armë të sofistikuar sa arsenalin i tillë luftarak duket sikur një përgatitje për luftë me një mekanizëm ushtarak që nuk mund t'i përbëjë bashkërisht të gjitha shtetet e Ballkanit.

Vendet euro-atlantike janë munduar ta shmangin përfshirjen luftarake dhe kështu kanë shmangur një konflikt midis superfuqive dhe, mbase, edhe një luftë të re botërore. Luftën e Tretë, që do të mund të ishte fatale për njerëzimin, për shkak të arsenalit nuklear dhe gjasave që ai të vihet në përdorim.

Përkundër përmbajtjes së NATO-s, megjithatë gjasat janë shumë reale, fatkeqësisht, për një konflikt shumë potencial në Ballkanin Perëndimor. Që nga luftërat e vitit 1991, me rastin e divorcimit shtetëror midis popujve të ish-Jugosllavisë, ishte Serbia ajo që me aspiratën e vet shoviniste për dominancë ndaj të tjerëve, që jo vetëm shkaktoi luftëra të përgjakshme, por edhe po vazhdon t'i mbajë si vatra krize katër shtete: Kosovën, Bosnjë e Hercegovinën (BeH), Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut.

Nga këto, dy vatra krize u mbajtën në mënyrë permanente të hapura dhe aktive, ajo në Bosnjë-Hercegovinë dhe në Kosovë.

Në vatrën e parë të krizës, përmes Republikës Serbe, në krye me Milorad Dodik, shovinizmi serb i Beogradit e mban gjendjen të tensionuar dhe me kërcënime të vazhdueshme për shpëtim nga federata e BeH, me çka e kanë sfiduar gjeopolitikën perëndimore (BE, ShBA e NATO dhe bazat e Marrëveshjes së Dejtonit 1995).

Në vatrën e dytë të krizës, përmes instrumentalizimit të kastave të inkriminuara politike të minoritetit serb në Kosovë, shovinizmi serb i Beogradit ka arritur për më shumë se dy dekada e gjysmë ta mbajë edhe konstituimin shtetëror të Kosovës peng dhe ta shndërrojë dialogun në farsë prej të cilit ka përfituar shumë Serbia pa bërë asnjë ndryshim real. Sfidimi i gjeopolitikës perëndimore në rastin e Kosovës është edhe më evident, pasi që ka të bëjë drejtpërdrejt me relacionet me vetë NATO-n, ShBA-në dhe BE-në.

Shovinizmi i Beogradit ka arritur ta manipulojë Perëndimin, posaçërisht ShBA-në dhe BE-në, duke luajtur po teza të shumëllojshme, herë duke lozur viktimitë, herë duke koketuar, herë duke flirtuar e më së shpeshti duke premtuar prapa perdeve gatishmërinë për integrim në gjeopolitikën perëndimore, por me shumë kujdes për shkak të rrezikut rus. Dhe Perëndimi bukur shumë ka rënë në të - për shumë gjëra dhe me dekada. Por shovinizmi serb nuk mund të zbutet, as të emancipohet e as të iluminohet, me asnjë koncesion, sepse nuk mund të heqë dorë nga substanca ekspansioniste përgjithësisht ndaj popujve të tjerë e sidomos ndaj shqiptarëve. Mbase është koha e fundit kur Perëndimi duhet ta shtrojë pyetjen: vullneti i deklaruar verbalist, përse në praktikë e veprime po shkon krejt në drejtim të kundërt? Përse qëndrimet verbale duken si vullnet i ndrydhur për bashkëpunim me Perëndimin, kurse ato janë shumë të hapura e intensive në shërbim të gjeopolitikës ruse?

Shovinizmi serb i Beogradit ka dhe dy vatra të tjera të krizës potenciale të cilat mund t'i aktivizojë në interes të gjeopolitikës agresioniste ruse, por edhe të tij në sinkronizim. Njëra, më potenciale, është Mali i Zi. Tashmë disa herë ka provuar të ndezë konflikte të brendshme dhe e ka trazuar seriozisht këtë vend. Të gjitha këto janë veprime drejtpërdrejt kundër një vendi kandidat për BE, e për më tepër edhe anëtar i 29-të i NATO-s (25 qershor 2017). Minoriteti serb është një bazë ku mbështetet shovinizmi serb, për shkak të numrit relativisht të madh. Një mbështetje tjetër është kisha ortodokse serbe, e cila ka ndikim të madh. Në zgjedhjet e vitit 2023, nën ndikimin e Beogradit shovinist,

arritën të marrin pushtetin në Podgoricë forca politike pro shovinizmit serb, gjë që mund të rrezikojnë paqen, stabilitetin dhe sigurinë e këtij shteti. Këtu, shovinizmi i Beogradit e shmang konfliktin drejtpërdrejt në NATO-n duke e nxitur konfliktin e brendshëm qytetar - kundër shtetit.

Një tjetër vend, po ashtu potencial, është Maqedonia e Veriut, vendi i 30-të anëtar i NATO-s (27 mars 2020), dhe vend kandidat për anëtarësim në BE. Ndonëse numri i minoritetit serb nuk paraqet ndonjë rrezik real, është kisha ortodokse ajo që mundet të ndikojë në funksion të shovinizmit serb. Po ashtu, elementët politik shovinistë maqedonas mund të nxiten përmes kanaleve të ndryshme për të provokuar shqiptarët dhe kështu të shkaktojnë tensione ndëretnike. Ende është i freskët rasti se si forcat shoviniste mësynë marrjen me dhunë të parlamentit maqedonas, ku, ndër të tjerë, u vunë në fokus edhe politikanë shqiptarë. Ndonëse në NATO, edhe për këto dy vende rreziku i shovinizmit serb të Beogradit mbetet real dhe mundet të marrë trajta të tilla që ta trazojë edhe vetë NATO-n.

Se cilën apo cilat nga këto katër vatra do t'i aktivizojë shovinizmi serb do të varet nga interesat e tij dhe të vëllamit të tij rus.

Në BeH Dodik jo rrallë ka kërcënuar me konflikt, me vënien në veprim të arsenalit ushtarak serb. Po ashtu ai ka takuar dhe komunikim intern. Kjo bëhet për t'i treguar Perëndimit qëllimshëm afërsinë me Rusinë. Nuk do mend se Dodik yshtet edhe nga Vuçiq e edhe nga Putini. Duke i parë kërcënimet që i bënë Dodik, EUFOR-i atje ia ktheu me të njëjtën gjuhë, duke i treguar se jo kanë kufijtë përtej të cilëve nuk do të tolerohet. Madje, edhe avionë luftarak amerikanë në stërvitje kaluan mbi territorin ajror të BeH, për të demonstruar prezencën dhe seriozitetin e mbrojtjes së territorin evropian. Të gjitha këto, tregojnë potencën e një konflikti në interes të gjeostrategjisë ruso-serbe kundër BE-së e ShBA-së, si dhe kundër Perëndimit.

Megjithatë më real dhe më i mundshmi mbetet skenari i Kosovës. Ky skenar sa drejtohet kundër shqiptarëve, po aq edhe kundër Perëndimit, pasi që NATO-ja e ka përgjegjësinë e sigurisë së Kosovës. Me një konflikt në Kosovë do të goditej sa shtetndërtimi i Kosovës, po aq edhe gjeostrategjia dhe gjeopolitika amerikano-evropiane. Dihet se disa herë Serbia e ka mësyre Kosovën: ju kujtohet treni me parulla kundër Kosovës? ju kujtohet kur edhe aviacioni luftarak serb u vu në lëvizje dhe cenoi madje edhe hapësirën ajrore të Kosovës? ju kujtohet parulla "Kur

të kthehet ushtria serbe në Kosovë" që po bëhet një vit që shfaqet gjithandej e orkestruar nga shovinizmi serb? nuk ka se si të mos ju kujtohet edhe përlëshja e forcave kriminale serbe në veri të Kosovës me forcat e KFOR-it (ky ishte, de facto, sulmi i parë direkt i shovinizmit serb kundër NATO-s)? dhe së fundi ju kujtohen njësitet diversioniste që hynë nga Serbia, ku edhe u përgatitën dhe u furnizuan me armë, për të shkaktuar një kryengritje të armatosur - kryengritje e secila ishte vetëm një insert më 24 shtator?

Të gjitha këto janë indikatorë se në shënjestër është Kosova.

Shovinizmi serb ka arritur t'ia hedhë Perëndimit, para së gjithash, ShBA-së dhe BE-së, duke aktruar sikur Vuçiqi dëshiron të bashkëpunojë me Perëndimin e të integrohet në mekanizmat e saj, porse me një takt më të ngadaltë, gjoja për mos ta acaruar Rusinë. E vërtetë se shovinizmi serb ka lejuar instalimin e forcave të ndryshme ruse në Serbi, në mënyrë legale e jo legale, ndikimi i të cilave mund të jetë me përmasa të panjohura në jetën e vendit, dhe sidomos në mekanizmat e sigurisë.

Shovinizmi serb nuk ndjehet i kërcënuar nga rusët, por i mbështetur, ua shton besimin në mundësitë e tyre, dhe është streha e fundit në kundërvënien ndaj Perëndimit.

Shovinizmi serb ndonëse trumbeton interesat serbe, në të vërtetë, ato janë interesa për pushtet, për përfitime financiare nga shteti e kriminaliteti. Kjo u pa qartë në demonstratat qytetare kundër vjedhjes së zgjedhjeve në dhjetor të vitit të kaluar, ku dhuna ndaj tyre më kujtonte skenat e dhunës ndaj shqiptarëve të Kosovës në vitet e '90-ta. Për të është armik gjithkush që i kundërvihet, armik që duhet trajtuar armiqësisht. Një shembull drastik është sjellja aq brutale e javës së parë të janarit të këtij viti ndaj ish-kandidatit për president Nikola Sandulović i cili vendosi lule te një varr i fëmijëve të Jasharëve në Prekaz dhe kërkoi falje për këtë krim, rrahja brutale e të cilit më kujton skenat e torturave të shqiptarëve të burgosur, të cilët nuk kishin bërë asnjë krim përveç se kishin kërkuar liri dhe barazi me kombet e tjera.

Me këtë manifestim të dhunës së hapur e të egër shtetërore ndaj civilëve duan t'i dërgojnë mesazh edhe serbëve e edhe Perëndimit, se nuk do të tolerohet as vullneti qytetar serb e as Perëndimit që të preket pushteti shovinist në Beograd, se çdo ndërhyrje do t'i kundërpërgjigjen me anë të forcës. Për këtë Serbia është mjaft mirë e armatosur, dhe po synohet me shpejtësi edhe futja e shërbimit ushtarak të detyrueshëm - që po ashtu është indikator për përgatitje për mobilizim të detyruar të popullit për luftë!

Tashmë është dhënë alarmi se në afërsi të kufijve me Kosovën po stërviten me qindra serbë por edhe mercenarë. Në këto përmasa, nuk mund të bëhet pa dijeninë dhe pa mbështetjen e organeve të sigurisë së Serbisë. Kjo është një sjellje provokuese kundër NATO-s. Se ky është një rrezik real, tërthorazi, e nxjerr në pah edhe shtimi i numrit të ushtarëve të NATO-s në Kosovë, si dhe shtimi i patrullimit të këtyre forcave në kufirin me Serbinë.

Nga kjo rrjedhë se Kosova mund t'i ekspozohet realisht një rreziku serioz të një konflikti të armatosur, me ç'rast, 24 shtatori i Banjskës do të mbetej vetëm një sprovë për të hetuar dobësitë dhe se mund të jepen goditje, goditje nga brenda, ani se të ardhura në mënyrë diversante nga jashtë.

Por, nëse kjo do të ndodhte, gjasat janë që kësaj here, njësitet diversioniste do të kishin mbështetje jo vetëm logistike, por edhe mbështetje ushtarake nga shteti serb.

A është diçka e gjasshme apo vetëm manovrim strategjik i shovinizmit serb të Beogradit, do ta tregojë koha, dhe e mira e popujve të Ballkanit do të ishte që ky të ishte vetëm një hamendësim, dhe të mos ndodhte në realitet.

Megjithatë, duhet t'i kushtohet vëmendje dhe të mos neglizhohet kjo prire e Beogradit, pasi që dy herë brenda një shekulli ka goditur Perëndimin.

Le të silltet ndërmend se në dekadën e dytë të shekullit XX ishin atentatorët serbë që në Sarajevë, kryeqytetin e BeH, duke vrarë arkidukën Franz Ferdinand, shkakuan Luftën e Parë Botërore. Mbase, po të gjurmohet, edhe nxitja e atentatorëve mund të shkojë deri në Rusi. Klima për luftë ishte krijuar nga fryma konfliktuoze dhe antagonist midis shtetesh të ndryshme në Evropë. Sidoqoftë, në një rrethanë të tillë të mbarsur me tension, ka mjaftuar një atentat ndaj arkidukës - për të ndezur shkëndijat e një luftë botërore.

Edhe kur gjendja ishte në disfavorin e një agresioni të mundshëm, sikurse ishin dy vitet e fundit të shekullit XX, përsëri shovinizmi serb në krye me Millosheviqin nuk hezitoi të shkonte deri në fund, duke hyrë në luftë edhe me NATO. Ishte një luftë (24 mars - 11 qershor 1999) në të cilën Serbia ishte e vetme kundër NATO-s.

Kurse në këtë dekadë të tretë të shekullit XXI, gjendja në Evropë është edhe më e rënduar në aspektin e luftës se ç'ishte në dekadën e dytë të shekullit XX. Nga 24 shkurti 2022 kur filloi agresioni rus në Ukrainë, ai po vazhdon ende me të njëjtin intensitet. Politika agresive, luftënxitëse e Rusisë është bërë krejt e hapur dhe Rusia kërcënon edhe vendet e BE, si

Suedinë dhe Finlandën, madje kërcënon edhe vendet Baltike, por edhe Poloninë e kënd do tjetër. Janë disa herë që Rusia e ka përsëritur mundësinë e përdorimit të armëve nuklear, madje në një rast ka dërguar një aeroplan të armëve nuklear në hapësirat ajrore të Suedisë. Vetëm për Serbinë ka shprehur gjithnjë mbështetje dhe këtë e bën edhe tash, e që ka domethënie sepse është mbështetje e veprimeve kundër NATO-s në Kosovë, pra është një nxitje për veprime kundër gjeopolitikës amerikano-evropiane.

E çka mundet specifikisht kjo të ketë rrjedhoja për Kosovën? Klasat politike ruse në krye me Putinin i ka dhënë vazhdimisht mbështetje të hapur shovinizmit serb, në çdo veprim që drejtpërdrejt ose tërthorazi ka shkuar kundër gjeopolitikës perëndimore, ku janë shkakuar tensione, konflikte, përpjekje për puçe e deri edhe te nismat për luftë të armatosur me objektivat kundër Kosovës, BeH, Malit të Zi e Maqedonisë së Veriut. Kjo mbështetje i ka dhënë guxim dhe forcë shovinizmit serb ne krye me Vuçiq që të mbahet dhe të vazhdojë. Dhe këtë qëndrim të Ruisë, si dhe raportet e kësaj me ShBA-Britaninë e Madhe e me BE ka ditur t'i shfrytëzojë shovinizmi serb në krye me Vuçiqin. Duke pasur për gjithësisht një linjë ideologjike shoviniste (thuhet se përjashtim bënte vetëm Zoran Gjingjiq, i cili donte ta bënte Serbinë perëndimore, mirëpo ndaj tij u bë atentat më 12 mars 2003, ende i pandriçuar), shovinizmi serb me dialogun, në të vërtetë, ka vepruar, në njërën anë, si amortizues i nismave amerikane, britanike e evropiane dhe, në anën tjetër, ka arritur t'i lajthisë e t'i bindë për t'u imponuar shqiptarëve marrëveshje që cungojnë e paralajzojnë shtetin e Kosovës (enklavizimi i komunave, krijimi i komunave me tri fshatra serbe e pastaj lidhja e tyre në Asociacion (2013, 2023) që është një derivat i një shteti si Republika Serbe në Bosnjë, si dhe ekstra-territorialitet për kishat ortodokse serbe në Kosovë). Tashmë do të duhej të ishte e qartë se shovinizmi serb kishte një qasje me taktikë amortizimi të gjeopolitikës amerikano-evropiane për paqe, stabilitet e siguri në raport me Kosovën dhe me BeH, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, e drejtpërdrejt në funksion të gjeopolitikës ruse. Ajo krijoi perceptimin sikur Beogradi shovinist ishte konstruktiv, flirtonte me Perëndimin e që vetëm lufta e Ruisë në Ukrainë, e sidomos përpjekja diversioniste e 24 shtatorit në Banjskë, dhe zgjedhjet e fundit ne Serbi - duket se i bënë amerikano-evropianët të kuptojnë se ishin manipuluar. Synimi ishte për të krijuar një perceptim se amerikano-evropianët janë të pazotët për të bërë paqe e siguri në Ballkanin Perëndimor, se shovinizmi serb ishte i zoti të prishte çdo taktikë e strategji gjeopolitike. Për më tepër, të gjitha këto i kishte arritur Beogradi pa ia vënë asnjë sanksion Ruisë për agresionin ndaj

Ukrainës e që nuk e ka bërë ende as sot.

Vatrat e hapura të krizës të shkaktuara nga shovinizmi serb në Kosovë e në BeH, kurse vatrat latente në Mal të Zi e në Maqedoni të Veriut, mbaheshin për të tërhequr vëmendje e Perëndimit, për t'i shpërqendruar forcat dhe angazhimet e tyre dhe për t'i mbajtur të angazhuar në këto pjesë. Ky ishte një operim de facto në kuadër të gjeopolitikës së Putinit, i cili ka deklaruar hapur armiqësia ndaj ShBA-së dhe Britanisë së Madhe në frymën e filozofisë reaksionare të Aleksadër Dugin, përmbushjen e së cilës duket se e ka marrë përsipër. Shovinizmi serb është aleat i natyrshëm, gjenetik, me politikat ekspansioniste ruse. Përmes shovinizmit serb, Rusia po i tregon Perëndimit, se ka në duar një kartë, të cilën mund ta luajë kundër tyre. Madje ka dhe një koherencë ruso-serbe në politikat e jashtme (jo rastësisht kanë krijuar komisione të përbashkëta për koordinim). Serbia, për të justifikuar mosvënien e sanksioneve Ruisë për shkak të agresionit në Ukrainë, i ka kujtuar Perëndimit intervenimin “e padrejtë” të NATO-s kundër Serbisë në pranverë të vitit 1999, duke e barazuar aktin rus prej agresori me aktin mbrojtës të NATO-s ndaj popullatës civile shqiptare. Si mbështetje, edhe Rusia përdorë të njëjtat argumente për agresionin në Ukrainë. Ky sinkronizim në gjeopolitikë paralajmëron një mundësi të një veprimi të orkestruar ekspansionist rus, për ta futur Evropën në sandviç. Vatrat e krizave në Ballkanin Perëndimor që Serbia i ka mbajtur aktive mund të krijojnë një pretekst të ri shumë të rrezikshëm në funksion të Ruisë që t'i shtojë pretendimet e veta edhe në Ballkan Perëndimor.

Ajo që mund të ketë mbetur si e nënkuptueshme, këtu duhet të shtjellohet më konkretisht. Duke qenë Vuçiq në një krizë të madhe të pushtetit nga zgjedhjet dhe protestat në Serbi dhe nga paralajmërimet e BE se nuk do të tolerohet më loja manipuluese e Serbisë, ai është në dispozicion të çdo veprimi, me të cilin do të gjykonte se do të përfitonte personalisht për të shpëtuar veten e vet nga një përfundim si Millosheviq. Po t'i jepen garanci nga Perëndimi për një shtet serb brenda Kosovës dhe po ashtu për lënien e tij në pushtet - mundet të amortizohen ndoshta konfliktet potenciale, sado që Rusia do ta nxisë në veprime të tilla. Në të kundërtën, ai i ka gjithherë të hapur krihet e Ruisë për përqaftim! Një skenar i mundshëm, fjala vjen, do të ishte ky. Serbia deklarohet se po i bëhet “presion i padrejtë dhe i papranueshëm nga Perëndimi për kompromise që do të dëmtojnë interesin e Serbisë” (në të vërtetë interesin shovinist) dhe të kërkojë shpëtimin nga Rusia! Kjo mundësi nuk është fantazi, as imagjinatë, po deduktohet nga një deklaratë sinjikative e Maria Zakharova, zëdhënëse e Ministrisë



së Jashtme ruse. Ajo më 5 janar 2022, kishte thënë se gjatë dyqind viteve të fundit, mbrojtja e Serbisë në masë të madhe ishte varur nga reagimi i shpejtë i Ruisë ndaj kërcënimeve të jashtme ndaj atij vendi sllav jugor. Kjo ekspozonte qëllimshëm gjeostrategjinë sinkrone ruso-serbe. Në këtë linjë, kur Vuçiq kishte nxitur tensione në veri të Kosovës përmes instrumentalizimit të Listës Serbe, më 2 gusht 2022, ajo tha se Serbia nuk i ka kërkuar ndihmë Ruisë për zgjidhjen në veri. “Nuk na e ka kërkuar Serbia ndihmën tonë”, e theksoi ajo, menjë mesazh të nënkuptueshëm, që lidhje me “reagimin e shpejtë të Ruisë” në mbrojtje të Serbisë. Dhe kjo deklaratë erdhi si mbështetje e tërthortë ndaj kërcënimeve të Vuçiq me sulm ushtarak mbi Kosovën, për çka Serbia është pajisur me arsenal modern ushtarak nga Rusia dhe nga Kina, merr përmasa serioze, dhe paralajmëron luftë në, brenda ose kundër territorit të Kosovës.

Këtu duhet lexuar një prapavijë tjetër, që duhet mbajtur kurdohërë parasysht. “Nuk na e ka kërkuar ndihmën tonë Serbia” është një fjali që shpreh një mundësi krejt tjetër, që deri të ky deklarim, nuk është artikulluar asnjëherë me këtë dimension dhe nga askush. Edhe me këtë qëndrim, Rusia ia krijoi një favor dhe ia forcoi pozitën shovinizmit serb në Ballkan, duke i thënë se mund të na ftoni. Modeli është i ngjashëm ftesën e Luhansk dhe Donetsk që i bënë Ruisë, pretekst ky me të cilin nisi invadimi i tërë Ukrainës. Vetëm se në këtë rast, do të ishte me dimensione edhe më të mëdha. Ky është një paralajmërim, që nuk duhet injoruar! Ndonëse në dukje flitet vetëm “për ndihmë Serbisë”, është e qartë se nuk është fjala për ndihmë ekonomike, as për drithëra, as për energji, po është fjala për politikë, madje për dimensionin e saj ushtarak (le të kujtohet këtu thënia e Klausevicit se “lufta nuk është asgjë tjetër përveç se vazhdim i së njëjtës politikë, vetëm se me mjete të tjera dhe pikërisht me mjete luftarake”). Objektivi formal është “mbrojtja e Serbisë” kundër Kosovës, por e vërteta është se goditja do të jetë shumë përtej: Perëndim, ShBA e

BE. Do të ishte një kërcënim drejtpërdrejtë ndaj NATO-s, pasi që kjo është garantuese ndërkombëtare e sigurisë në Kosovë, ku përfshihet edhe veriu si pjesë integrale e saj. Duke u ftuar në emër të shtetit, forcat ruse do të vendoseshin në Serbi, pra në Ballkanin Perëndimor, në brendi të Evropës, në një terren gjeopolitik (Serbi, e mbase edhe në Republikën Serbe) me klimë pro ruse. Kjo, madje, jo rastësisht edhe u shpreh me manifestime demonstrative në Beograd (4 mars 2022), kur i kërkohej Serbisë të dënonte invadimin rus të Ukrainës, dhe mijëra qytetarë dolën me parulla në mbështetje të Ruisë (që më tepër dukej si një ftesë drejtuar Ruisë që të mos i braktisë politikat shoviniste serbe). Ndonëse mundet të tingëllojë surrealiste kjo që po aludohet këtu, rreziku real është se njëmend Rusia mund t'i dislokojë forcat e veta në Serbi dhe ta shpallë sferë interesi rus. Pretekstet: Serbia nuk është anëtare e NATO-s e as anëtare e BE-së. Ky është një rrezik, i cili nuk mund të përjashtohet.

Dhe, në një rast të tillë, çfarë do të ndodhte? Le të supozohet se Serbia kërkon ndihmën ruse, ose kjo mund të inskenohet edhe përmes ndonjë lëvizjeje politike shoviniste gjoja qytetare për të kërkuar ndihmën (që duhet ta bëjë, por që gjoja nuk po e bën, qeveria serbe e në vend të saj po e bën populli domethënë “sovrani”). Atëherë, si do të vepronte Rusia? A ka gjasa, të dërgonte trupat e veta ushtarake në Serbi (e mbase edhe në Republikën Serbe) ? Nëse gjykohet me logjikën e Putinit, kjo do të mund të ndodhte, sepse do të ishte në funksion të gjeopolitikës antiperëndimore dhe si një veprim taktik në gjeostrategjinë anti-NATO. Gjasat janë që ai të mos hezitonte ta bënte këtë. Dhe krejt kjo do të kamufllohej në emër të mbrojtjes së “vëllezërve serbë nga terrori i ShBA-së dhe i Mbretërisë së Bashkuar”. E si janë gjasat të veprojnë vendet anëtare të NATO-s, si ShBA, Mbretëria e Bashkuar, BE? A do ta lejonin Rusinë të instalohej në Serbi, sidomos duke i pasur të qarta pasojat afatgjata: do të (ri)krijoheshin dy blloqet

ushtarake ballë për ballë: Rusia dhe NATO? Nëse po, në miniaturë, Ballkani do të bëhej një vend ku ndahen dhe takohen dy botë, Perëndimi dhe Rusia, që të kujton botën dypolare: NATO - Traktati i Varshavës. Nëse do të veprohej për ta penguar, kjo, afërmendsh, do të ishte nisje e një luftë midis NATO-s dhe Ruisë bashkë me aleatët e saj, ku, mbase, pas një kohë do të mund të përfshihej edhe Kina, Irani, Koreja e Veriut etj., dhe kështu të fillonte faktikisht një luftë e tretë botërore, me rrezik të eskalonte në një luftë nukleare. Ministri i jashtëm britanik, këtyre ditëve në Kosovë, në një farë mënyre, dha një përgjigje ndaj skenarit të mundshëm për agresion, ashtu sikurse ishte ai i Banjskës më 24 shtator 2023. Ai tha se do të luftonin, në mbrojtje të Kosovës. Ky ishte një mesazh pa ekuivoke, të cilin e konfirmoi edhe Foreign Office i Mbretërisë së Bashkuar. Arsyeja e qartë: një sulm ushtarak, nga jashtë ose i orkestruar nga Serbia kundër Kosovës, është sulm ndaj vetë NATO-s. Dhe NATO-ja nuk mund të durojë të sulmohet ushtarakisht, pa i kthyer goditjet. Nëse agresioni serb edhe pas këtij paralajmërimi ndodh, domethënë se bëhet me sinkronizim me Rusinë për të dislokuar forcat ushtarake ruse në Serbi, që do të ishte një pushtim realisht i Serbisë, por edhe një kërcënim me përmasa të panjohura deri më tash për Kosovën dhe për shqiptarët përgjithësisht.

Në një konstelacion të këtillë, shqiptarët do të gjendeshin në një rrethanë të mbarsur me rreziqe të shumta e të llojllojshme. Ata do të gjendeshin në vorbullën e një vatre krize që i kalon pakrahasimisht raportet Kosovë - Serbi, raportet në rajon dhe në kontinent, e merr përmasa ndërkombëtare, përmasa të krijimit të dy fronteve ballë për ballë, në llogoreve armiqësore: Rusi-NATO. Kosova e shqiptarët do të gjendeshin, krejt pa dashje, në vijën frontale, në linjën e parë të zjarrit. Si përfundim, i ngutshëm dhe imediat është bashkërendimi i përpiktë me ShBA-në dhe BE-në si dhe me NATO-n. Nëse nuk bëhet kjo në politikë, Kosova ka rrezik të mos e kryejë detyrën e shtëpisë.

Kriza energjetike, qeveria ndan 16 milionë euro

PRISHTINË, 10 JANAR - Qeveria e Kosovës ka ndarë 16 milionë euro për zbatimin e masave 1 dhe 4 të planit të veprimit për zbutjen e ndikimit të menjëhershëm socio-ekonomik të krizës energjetike, gjersa prej tyre 11 milionë i shkojnë Ministrisë

së Financave, Punës dhe Transfereve në mënyrë që të bëhet mbulimi i pagesës për familjet e cënueshme. Ministri i Financave, Hekuran Murati, tha se 5 milionë shkojnë për Ministrinë e Ekonomisë dhe 11 milionë për Ministrinë e

Financave, Punës dhe Transfereve, te programi ndihma sociale. Muaj më parë Qeveria e Kosovës pati vendosur subvencionimin e energjisë elektrike për familjet me të ardhura mesatare mujore më pak se 150 euro.



Bajrami reagon ndaj ministrit Murati: Po manipulon me shifra për t'i fshehur dështimet

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 JANAR - Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, i ka reaguar ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, për të dhënat që i ka paraqitur nga raporti preliminar i shpenzimit të buxhetit, sipas të cilit, në vitin 2023 shpenzimet janë rritur 13 për qind krahasuar me vitin paraprak. “Hekuran Murati paska manipuluar sërish me numrat në formë të përqindjeve. Për të, interpretimi i shifrave faktike, në vend se ta tregojë gjendjen reale, bëhet instrument për ta manipuluar syrin e militantit, ndërsa realiteti shihet qartë për ata që duan të shohin. Në fakt, kushdo që jeton në Kosovë e di se zhvillimi infrastrukturor i shtetit është lënë në harresë nga një qeveri e cila po e përfundon mandatin katërvjeçar vetëm me pëdurimin e urës së vogël të Staradranit dhe me ndërtimin e katër çerdheve nga 160 të premtuara. Hekuran Murati paska thënë se shpenzimet buxhetore për vitin 2023 janë rritur 13 për qind në krahasim me një vit më herët, por do të ishte më fer të tregohej se këto shpenzime, duke e përfshirë edhe lëmoshën e shpërndarë në fund të vitit, arrijnë shumën totale prej 2.966 miliardë eurosh, apo saktësisht 342 milionë euro më pak se buxheti i planifikuar (3,238 miliardë euro)”, ka shkruar Bajrami në “Facebook”. Ajo në vazhdim ka theksuar se Murati paska thënë se shpenzimet kapitale qenkan rritur për 32 për qind në krahasim me vitin 2022 dhe, sipas deputetes së LDK-së, nëse kjo është e saktë, i bie që në total janë shpenzuar 557 milionë euro apo 262 milionë euro më pak se buxheti i planifikuar (819 miliardë euro). “A e di Hekurani se



paaftësia për ta shpenzuar një buxhet të planifikuar nuk është arritje me të cilën mund të mburresh, por cilësohet si dështim, mungesë vizioni dhe simptomë e keqmenaxhimit? Shpenzimet për paga dhe shtesa qenkan rritur për 111 milionë euro dhe, sipas tij, pagat në sektorin publik qenkan rritur për 17 për qind. Por mesatarja këtu sërish nuk e tregon realitetin sepse derisa Hekuranit i është rritur paga për 450 euro vitin e kaluar, ka kategori të tjera që kanë pasur ulje të pagës, dhe ka të tillë të cilëve paga nuk u ka lëvizur prej vitit 2016. Andaj është mirë që Hekurani ta dijë se kur ai han dardha nuk do të thotë se të tjerëve u pihen dhëmbët”, është shprehur Bajrami. Ndërsa për mallra dhe shërbime, sipas Bajramit, ministri Murati paska thënë se ka rritje për 17 për qind. “Paska thënë se 17 për qind e 337 milionëve është më pak se 17 për qind e 653 milionëve. Këtë

vetëm gjenitë në qeverinë Kurti dinë ta deshifrojnë. Pra, për mallra dhe shërbime në vitin që lamë pas janë shpenzuar 394 milionë euro dhe kjo rritje ka shkuar kryesisht në luksin e qeveritarëve sepse spitalet i kemi pasur pa barna e policët pa pajisje gjatë tërë vitit”, është shprehur Bajrami. Ajo ka theksuar se Murati paska provuar me krenari të na tregojë se subvencionet dhe transferet në vitin 2023 janë rritur për vetëm 1 për qind por, sipas saj, shuma absolute na tregon diçka tjetër. “Derisa në vitin 2022 kjo qeveri ka shpenzuar 1 miliard e 65 milionë euro për subvencione dhe transfere, apo 40 për qind të totalit buxhetor, këtë vit për subvencione dhe transfere paskan shpenzuar 1 miliard e 75 milionë euro, apo 36 për qind të buxhetit. E vlefshme për t'u theksuar se në të njëjtën kohë që kjo qeveri shpenzon gati gjysmën e buxhetit në subvencione, varfëria në vendin



tonë është në rritje sipas UNDP-së. Me të vërtetë arritje për t'u krenuar. E çudia më e madhe në shifrat e Hekuranit është kjo: Qeveria Kurti II për nëntë muaj të vitit 2023 ka shpenzuar 263 milionë euro për investime kapitale, ndërsa vetëm në tremujorin e fundit ka shpenzuar 294 milionë euro për investime kapitale. Si ka mundësi? Nëse duam t'i biem shkurt dhe t'i injorojmë absurditetet si kjo më lart, shifrat me të cilat po mburret Hekuran Murati në fakt vetëm se e tregojnë më se miri mospunën e kësaj qeverie. Mos të harrojmë se jemi më 9 janar 2024, ndërsa qeveria Kurti II e ka marrë mandatin më 22 mars të vitit 2021”, ka deklaruar deputetja Bajrami. Një ditë më parë ministri i Financave, Hekuran Murati, ka thënë se, sipas raportit preliminar të shpenzimit të buxhetit, në vitin 2023 shpenzimet janë rritur për 13

për qind më shumë krahasuar me vitin 2022. Murati ka thënë se kategoria që është rritur më së shumti në vitin 2023 është ajo e investimeve kapitale, 32 për qind më shumë se në vitin 2022. “Kategoria paga dhe shtesa është e dyta me kontributin më të madh në rritjen e buxhetit, me 114 milionë euro më shumë, apo 17 për qind më shumë sesa viti 2022. Kjo tregon se në sektorin publik ka pasur rritje mesatare të pagave që ka tejkaluar shkallën mesatare të inflacionit prej 11.6-përqindësh të vitit 2022. Mallrat dhe shërbimet, gjithashtu me 17 për qind, kanë trendin e njëjtë të rritjes, mirëpo si vlerë absolute rritja është përgjysmë më pak sesa kategoria paga dhe shtesa”, ka shkruar Murati në “Facebook”. Më tutje, ai ka thënë se kategoria me më së paku rritje në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022, ishte ajo e subvencioneve dhe transfereve, me vetëm 1 për qind.

Emërohen anëtarët e Bordit të “Trainkosit” dhe KRU “Mitrovica”

PRISHTINË, 10 JANAR - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e të mërkurës ka miratuar vendimin për emërimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes “Trainkos” dhe, po ashtu, edhe anëtarët e Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit

“Mitrovica”. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije se kryesues i Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes “Trainkos” do të jetë Jetmir Nuka. Ndërkaq anëtarë të bordit janë emëruar Vjollca Salihu, Luljeta Lutfiu, Ruzhdi Zeqiri,

Kimete Fazliu dhe Afrim Bulluti. “Mandati i të emëruarve zgjat tri vjet”, tha kryeministri. Ndërsa Aurora Dinaj është emëruar anëtare e Bordit të Drejtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit “Mitrovica”.



5 gabimet ushtarake që kanë vendosur fatin e Luftës së Dytë Botërore

1. Vonesa aleate në mbrojtjen e Skandinavisë

Tashmë nuk kishte më çfarë të bëhej. Trupat aleate më 18 qershor 1940 ua rihipën anijeve me ngut dhe lanë prapa krahëve Norvegjinë, preja e radhës e nazistëve. Dy muaj më parë ushtarët e Londrës dhe Parisit kishin nxituar drejt vendit skandinav për ta mbrojtur nga Hitleri, por kishin dështuar në detyrën e tyre. Aty, në fillim të Luftës së Dytë Botërore, ishte luajtur një lëvizje e rëndësishme strategjike dhe loja u vendos nga qëndrimet e kundërta që e mbajtën Berlinin nga njëra anë dhe Londrën e Parisin nga ana tjetër ndaj vendeve skandinave, teorikisht neutrale. Duke respektuar rregullat e diplomacisë ndërkombëtare, Londra dhe Parisi u mundën në elementin kohë nga nazistët, që nuk ndjeheshin të detyruar prej këtyre rregullave. Norvegjia ishte shumë e rëndësishme, pasi ofronte dy avantazhe domethënëse:

– nga njëra anë, tranzitin e hekurit suedez drejt industrive luftarake gjermane, nëpërmjet Portit të Narvik kur Deti Balltik ishte i mbuluar nga akujt, – nga ana tjetër, prania e porteve që shikonin nga Britania e Madhe nga veriu dhe mundësonin një rrugëdalje më pak të kontrollueshme të La Manshit drejt Oqeanit Atlantik dhe rrugëve tregtare të tij. Për muaj me radhë gjermanë dhe anglo – francezë kërkuar që ta tërhiqnin Oslon nga ana e tyre ose të paktën të garantonin një neutralitet të saj. Por shpejt qe e qartë për të gjithë se Norvegjia nuk ishte në gjendje ta ruante neutralitetin me forcat e sah. Për këto motive anglezët dhe francezët menduan që të dërgonin trupa për ta “mbrojtur” dhe rrethuar vendin. Prej kohësh

Churchill ishte një mbështetës i ndërhyrjes së armatosur, por u dëgjua shumë vonë. Nga ana e tij, Gjenerali gjerman Nikolaus von Folkenhorst realizoi operacionin e parë të kominuar të historisë ushtarake moderne, me përdorimin e njëkohshëm dhe masiv të forcave detare, ajrore dhe tokësore për ta marrë Norvegjinë. Sulmi arriti që ta paraprijë për një qime projektin e zbarkimit britanik. Më 9 prill, skuadrat detare gjermane nisën operacionet e pushtimit. Vetëm më 15 prill anglofrancezët zbarkuan nga ana e tyre për t’ju bashkangjitur forcave

norvegjeze që mezi po rezistonin. Por planifikimi aleat, përveçse pak i vrullshëm, ishte edhe i keqorganizuar dhe ushtarëve u mungonin deri pajimet e nevojshme për të luftuar dhe vepruar në zona me një klimë që mund të ishte shumë e ashpër. Kurse nazistët e patën kapur me shpejtësi kontrollin e hekurudhave dhe superioritetin ajror. Sidomos ky i fundit rezultoi vendimtar duke mundësuar që të mitraloheshin trupat armike dhe të mbaheshin larg anijet angleze. Më 21 prill në Lillehammer u verifikua përplasja e parë midis trupave gjermane dhe atyre britanike të Luftës së Dytë Botërore: një betejë shumë e ashpër, e zgjatur 24 orë, pas të cilës ushtarët britanikë dhe norvegjezë, tashmë të mundur, nisën të tërhiqeshin nga qyteti. Në ditët në vazhdim gjermanët morën një e nga një pozicionet në duart e armiqve në pjesën e mbetur të Norvegjisë, duke mbetur padronë të vendit që u braktis nga anglo – francezët në qershor. Ndërhyrja e tyre shumë e vonuar kishte rezultuar e kotë.

Çfarë do të kishte ndodhur sikur... Pa pushtimin e Norvegjisë, Hitleri do të kishte humbur furnizimet e çmuara me mineralet e hekurit nga Suedia, duke i parë kështu të



rritura vështirësitë gjermane në furnizimin me lëndë të para. Kjo patjetër që do të influenconte zgjedhjet strategjike dhe ecurinë e luftës së Hitlerit, që më pas gjithsesi u desh të përballej me mangësitë e këtyre lëndëve. Veç kësaj, Norvegjia luajti një rol të rëndësishëm në Betejën e Atlantikut, në të cilën nëndetëset gjermane vunë në provë të vështirë rrugët e furnizimit drejt Britanisë së Madhe dhe Bashkimit Sovjetik. Sikur të kontrollonte Norvegjinë të kishte qenë Londra në vend të Berlinit, atëhere i gjithë ekuilibri në dete do kishte ndryshuar në disavantazh të Gjermanisë.

2. Urdhëri i Hitlerit për të mos i asgjësuar anglezët në Dunker

Premtimet e kreut të Luftwaffe Hermann Wilhelm Göring, iluzioni i Hitlerit për t’i lënë një derë hapur Britanisë së Madhe,

preokupimet e komandantit të Frontit Perëndimor Marshallit Gerd von Rundstedt: qenë këta elementë që bënë të mundur “mrekullinë e Dunkerkut”. E dielë, 26 maj 1940 – kur ushtria franceze ishte në rrugë në frontin verior të pushtimit nazist – nisi Operacioni “Dinamo”, domethënë tentativa britanike për të shpëtuar sa më shumë ushtarë që të ishte e mundur duke i imbarkuar me shpejtësi drejt Anglisë. Trupat anglo – franceze në tërheqje u grumbulluan në plazhin e Dunkerque, që shpejt u rrethua nga divizionet gjermane. Të cilat u ndalën vetëm pak kilometra larg bregdetit. Motivi mbetet mister. Vendimi kontradiktor u mor nga Adolf Hitleri personalisht, por nuk janë kuptuar asnjëherë arsyet e vërteta e atij ngurrimi për t’u dhënë goditjen vdekjeprurëse armikut në tërheqje. Ndoshta Marshalli von Rundstedt e bindi se ndoshta ishte më mirë që t’u jepej pushim trupave dhe të çlodheshin panzerët që qenë çfilitur në garën e çfrenuar e nisur dy javë më parë. Sigurisht që Hermann Göring e siguroi Fyhrerin për faktin se vetëm aviacioni do të mjaftonte për t’i asgjësuar armiqët. Hitleri kishte edhe një qëllim tjetër: synonte që të bindëte Londrën që të arrinte një marrëveshje me të dhe, ka mundësi edhe për këtë, preferoi që të mos ndërhynte ndaj ushtarëve anglezë. Ato ditë pushimi i mundësuan kështu Britanisë së Madhe që të krijonin një flotë të improvizuar me çdo mjet lundues në dispozicion. Kështu, kundër çdo parashikimi të vetë strategëve britanikë, më 2 qershor u evakuua i fundit i 338000 ushtarëve. Midis tyre edhe 120000 francezëve që do të përbënin bërthamën e Francës

së Lirë të drejtuar nga Gjenerali Charles De Gaulle. Mund të thuhet me siguri se gabimi i Dunkerkut vendosi fatet e luftës. Çfarë do të kishte ndodhur sikur... Asgjësimi i trupave anglo – franceze në Dunkerque do të kishte vendosur një hipotekë serioze mbi luftën. Duke vepruar kështu, Hitleri do të kishte nxjerrë nga konflikti qindramijëra ushtarë armiq ekspertë dhe të stërvitur mirë, që në vijim u përdorën me sukses në betejë nga aleatët. Të njëjtat francezë formuan bërthamën e ringjalljes së mëpasme të Francës. Por sidomos asgjësimi i Trupës Ekspedicionare Britanike do të përfaqësonte një goditje psikologjike të rëndësishme në kuadër të luftës së nervave që Hitleri bënte me Britaninë për ta shtyrë që të kërkonte paqen.

3. Urdhëri i Mussolinit për të sulmuar Greqinë në dimër

Qe Adolf Hitleri ai që theksoi se sulmi jo i koordinuar italian ndaj Greqisë kishte influencuar negativisht ndaj Operacionit “Barbarossa” (pushtimit të Bashkimit Sovjetik) duke e vuuar aq shumë sa duhej për t’i penguar gjermanët për të pushtuar Moskën. Për hir të së vërtetës, historianët kanë shumë dyshime lidhur me një interpretim të tillë, por ky ishte mendimi i Fyhrerit. Ajo që është e sigurtë është se agresioni ndaj Greqisë qe një ndërthurje gabimesh të bujshme që e ndryshoi përfundimisht rolin e Italisë në luftë dhe në botë. Sulmi u dëshirua personalisht nga Mussolini, edhe për të kryer një luftë paralele ndaj asaj të Gjermanisë, duke u hakmarrë kështu ndaj Hitlerit për





shpërfilljen e treguar në marrjen e iniciativave luftarake pa u këshilluar me aleatin. Italianët i nisën operacionet ushtarake më 26 tetor, në vigjilje të sezonit të ftohtë, që do ta bënte të vështirë luftimin në malet e Epirit, ku u përqëndruan duke lëvizur nga Shqipëria. Veç kësaj, u rreshtuan më pak ushtarë nga sa u konsideruan të nevojshëm (nja 10 divizione respektivisht 20 të parashikuarve) dhe me një logjistikë katastrofike: portet shqiptare qenë të mbingarkuar dhe në konfuzion të plotë, rrugët e pakalueshme, mjetet e

transportit të papërshtatshme. Aviacioni italian nuk arriti kurrë që të ketë peshë për shkak të kohës së keqe dimërore. Ministri i Jashtëm Galeazzo Ciano theksoi se grekët qenë të korruptuar dhe se do t'i cedonin goditjes, por faktet e nxorrën gabim. Bullgaria dhe Turqia nuk ndërhyjnë në mbështetje të Italisë. Duke i dhënë ultimatumin qeverisë së Kryeministrit grek Ioanni Metaxas dhe, për pasojë, sulmin e bërë, Italia ka shpejt që t'i zhdukej iluzioni se “do t'ia thyenin brinjët Greqisë”.

Përkundrazi, pësoi një kundërsulm shkatërrimtar që i çoi grekët deri brenda Shqipërisë. Në valën e dështimit italian, në Jugosllavi pati një grusht shteti antiBosht. Në këtë pikë gjermanët i detyruan që të ndërhyjnë në Ballkan. I nënshtuan me shpejtësi, por vonuan me disa javë sulmin ndaj Bashkimit Sovjetik. Kështu që patën më pak kohë në dispozicion për pushtimin përpara se të ngecnin në dimrin rus. Ndërkohë, çdo besueshmëri e mbetur e Italisë ishte zhdukur. Çfarë do të kishte ndodhur

sikur... Fushata e Greqisë do të mund të fitohej. Mjaftonte të planifikohej më mirë dhe të mos bëheshin të gjitha gabimet që u bënë, duke filluar nga çmobilizimi i divizioneve rezervë që në mënyrë të pashpjegueshme u bë në verë. Sikur Italia ta kishte kontrolluar Greqinë, do të kishte pasur një impakt më të madh ndaj Mesdheut, me reperkusione edhe ndaj luftës në Afrikën Veriore. Veç kësaj, ndoshta do ta kishte sjellë Turqinë nga ana e Boshtit dhe, në këtë pikë, do të ishte hapur një rrugë tjetër drejt Lindjes së Mesme dhe Kaukazin, me rezervat e tyre të naftës. Së fundi, duke fituar në Greqi, Italia nuk do të ishte bërë vasale e Hitlerit, siç edhe ndodhi në fakt. Pastaj, për sa i përket Gjermanisë, sikur të mos kishte qenë e detyruar të ndërhynte në Ballkan, ajo do të kishte mundur të përqëndrohej më parë dhe më shumë me fushatën e Rusisë. Disa mendojnë se do ta kishte marrë Moskën dhe kjo do të kishte qenë një goditje vdekjeprurëse për Stalinin. Por, gjithsesi, ndoshta Bashkimi Sovjetik nuk do të ishte dorëzuar.

4. Vendimi i Japonisë për të përfshirë në luftë Shtetet e Bashkuara

Berlini, Roma dhe Tokio qenë bindur se herët a vonë do të

shpërthente lufta kundër Shteteve të Bashkuara. Në një farë mënyre, Amerika e kishte bërë tashmë zgjedhjen e saj me furnizimet masive për Britaninë e Madhe dhe Bashkimin Sovjetik, por njëkohësisht në Shtetet e Bashkuara në vitin 1941 partia neutraliste ishte e fortë dhe Karta Atlantike e gushtit të atij viti nuk përmendte asnjë ndërhyrje të drejtëpërdrejtë ushtarake të amerikanëve në teatrat e luftës. Kështu, për Gjermaninë, Japoninë dhe Italinë nuk ishte patjetër e domosdoshme ta zgjeronin përplasjen tek Shtetet e Bashkuara. Hitleri kishte menduar gjithmonë se shtyrja sa më shumë të ishte e mundur hyrjes në luftë e kolosit amerikan do të ishte një avantazh. Lideri nazist e kishte ekspozuar shumë herë idenë e tij lidhur me nevojën për t'i eliminuar një e nga një kundërshtarët europianë përpara se të hynin në luftë Shtetet e Bashkuara. Veç kësaj, për të ekzistonte një mundësi e largët marrëveshjeje me amerikanët për t'i ndarë kontinentet në dëm të fuqive të vjetra koloniale europiane. Vetë Pakti Tripalësh, duke ndarë sferat e influencës botërore midis Gjermanisë, Italisë dhe Japonisë, i linte zbuluar Amerikat. Nga ana e saj, Japonia ishte e impenjuar tashmë në luftën e saj në Kinë dhe ndoshta



do t'i kushtoj pushtimit të posedimeve koloniale angleze, franceze e hollandeze në Azi pa marrë iniciativën e përfshirjes së Shteteve të Bashkuara. Por Japonia dyshonte se në rastin e sulmit ndaj domeneve anglo – hollandeze, amerikanët nuk do të qëndronin duarkryq dhe e dinte se Shtetet e Bashkuara kishin nisur një politikë riarmatimi qysh nga viti 1940. Që kështu që më 7 dhjetor 1941 vendosi që t'i godasë befasisht Pearl Harbor. Por edhe në këtë pikë Gjermania dhe Italia nuk qenë të detyruara ta sfidonin Uashingtonin: Pakti Tripalësh me Japoninë nuk parashikonte një shpallje lufte automatike. Për ta demonstruar është fakti se Tokio nuk e sulmoi kurrë Bashkimin Sovjetik për të mbështetur aleatët europianë. Pavarësisht kësaj, më 11 dhjetor 1941 edhe Gjermania dhe Italia u shpallën luftë Shteteve të Bashkuara. Pse e bënë mbetet ende sot një enigmë.

Çfarë do të kishte ndodhur sikur... Beteja e Pearl Harbor hapi premisat e humbjes së forcave të Paktit Romë – Berlin – Tokio. Pearl Harbor përcaktoi hyrjen në konflikt të asaj fuqie që më pas do t'i shënonte ushtarakisht rezultatin. Në Shtetet e Bashkuara ekzistonte akoma një shpirt i fortë izolacionist dhe pas ulmin japonez hyrja në luftë e Uashingtonit do të vonohej. Në këtë pikë ndoshta japonezët do të kishin pasur dorë të lirë në Azi, ndërsa në Afrikë e në Europë italo – gjermanët nuk do të duhej të preokupoheshin për ndërhyrjen amerikane. Për shembull, nuk do të kishte ndodhur Operacioni “Torch”, me

të cilin në fundin e 1942 forcat aleate zbarkuan në Marok dhe shkaktuan humbjen përfundimtare të Boshtit në Afrikë. Dhe nga aty të njëjtat trupa nuk do ta pushtonin Siçilinë në korrikun e 1943, duke shkaktuar më 25 të këtij muaji rënien e regjimit fashist.

5. Urdhëri i Hitlerit për Armatën e VI që të mos tërhiqej nga Stalingradi

3 milion ushtarë i përfshinë në betejën e Stalingradit, ndoshta më e madhe e të gjithë historisë. 2 milion prej këtyre përfunduan të vdekur, të plagosur, të zhdukur apo robër lufte. Me këtë përlëshje fatet e Luftës së Dytë Botërore ndryshuan dhe iniciativa kaloi nga gjermanët tek rusët. Beteja u zhvillua midis fundit të gushtit të 1942 dhe shkurtit të 1943: Hitleri vendosi pushtimin e Stalingradit, qendër industriale mbi Vollgë që mbante emrin e diktatorit sovjetik, kishte një domethenie themelore. Për këtë, përdori Armatën e VI e Gjeneralit Friderich Paulis, e mbuluar nga krahët prej rumunëve, italianëve (mbi 220000), hungarezëve dhe aleatëve të tjerë. Për motive të kundërta, Stalini e mendonte në të njëjtën mënyrë: edhe për të Stalingradi nuk duhej të binte, edhe me koston e transferimit në një ferr. Përlëshja zgjati për muaj me radhë, shtëpi më shtëpi, me humbje të mëdha nga të dyja palët. Kur rusët i çanë frontet në të dyja krahët e qytetit duke e rrethuar, një lak u mbyll rreth Armatës së VI të Paulus, me mbi 250000 ushtarakë të zënë në kurrth. Ishte momenti i tërheqjes.



Edhe pse qytetit i afroheshin trupat e Gjeneralit Erich von Manstein, për të provuar të lidheshin divizionet gjermane dhe shpëtuar të shpëtueshmen. Do të kishte qenë e mundur që të mbijetonte një pjesë e njerëzve, por ndërsa tentativa e von Manstein për ta çarë rrethimin nuk ia arriti, forcat e Paulus mbetën të gozhduara në Stalingrado prej vullnetit eksplicit të Hitlerit, i cili dha urdhër që të rezistoj deri në njeriun e fundit. Bile, kur tashmë gjithçka ishte humbur, Fyhreri e gradoi Paulus Feldmarshall. Në fakt, kishte frikë se mos kapej i i gjallë dhe, duke e graduar, shpresonte që nderi i tij do t'i pengonte dorëzimin, duke qenë se ky fakt nuk kishte prekur deri në atë moment asnjë oficer gjerman me gradë kaq të lartë. Për të Hitleri uronte një



vetëvrasje për ta luajtur të paktën në planin e propagandës. Por Paulus, deri më atëherë gjithmonë i bindur ndaj urdhërave, zgjodhi që të shpëtojë dhe më 2 shkurt ju dorëzua sovjetikëve. Nga njerëzit e tij, 100000 kishin vdekur dhe po aq qenë kapur si robër lufte. Pjesa më e madhe e tyre nuk u kthye kurrë më në Gjermani.

Çfarë do të kishte ndodhur sikur... Sikur Hitleri do të kishte lejuar që të shpëtoheshin ushtarët e Armatës së VI ndoshta nuk do të ndryshonte krejtësisht rezultati i luftës në Rusi, por sigurisht që do të kishte pasur pasoja. Më e rëndësishmja ajo e natyrës psikologjike. Stalingradi që humbja e parë e madhe gjermane dhe fitorj e parë e madhe sovjetike. Një rezultat më pak i pastër i asgjësimit të një

armate të tërë do të ishte menaxhuar ndryshe nga të dyja palët. Edhe pse rusët nuk ia dolën në planin e tyre të madh për ta rrethuar të gjithë frontin jugor dhe gjermanët demonstuan se qenë në gjendje t'u përgjigjeshin sovjetikëve akoma në 1943. Sikur asaj që ndodhi t'i ishte shtuar disponueshmëria e Armatës së VI dhe një gjendje psikologjike jo e rënduar nga një ndjesi disfate (të cilës pala sovjetike i kundërvinte mitin e Luftës së Madhe Patriotike të ngritur pikërisht në Stalingrad) rezistenca gjermane në frontin lindor do të kishte mundur të zgjatej më shumë.

Përgatiti: ARMIN TIRANA / bota.al





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Besart Berisha fillon karrierën e trajnerit

PRISHTINË, 10 JANAR - Ish-futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë dhe Përfaqësueses së Kosovës, Besart Berisha, e ka filluar karrierën e trajnerit. Lajmin

e ka dhënë skuadra e Prishtinës në faqen zyrtare në "Facebook". "Pas përfundimit të karrierës profesionale, Besart Berisha ka vendosur të fillojë zejen e

trajnerit të ri te klubi ynë për çka FC Prishtina uron që në të ardhmen të kemi sukses së bashku", thuhet në njoftimin e skuadrës kryeqytetase. 38-vjeçari ka pasur karrierë të

pasur si futbollist. Ai ka luajtur për Arminia Bielefeldin, Hamburger SV, Melbourne Victory, Brisbane Roar e shumë skuadra të tjera.



Kozniku: Po të isha menaxher çdo ditë do ta mbushja nga një autobus me talentë nga Kosova

Ish-futbollisti i njohur shqiptar Ardian Kozniku ka folur për karrierën e bujshme që ka pasur dhe talentet që ka vendi nga ku vjen. Kozniku përmendi transferimin e ri të Dinamo Zagrebit, Arbër Hoxhën, për të cilin ka thënë se e njeh qëkur ishte te Ballkani. Sipas tij, atje ai tregoi se do të bëhej lojtar i madh.

"Sa i përket kompensimit, unë vërtet nuk do të hyja në këtë, sepse vetë klubet e dinë më së miri se sa buxhet kanë në dispozicion. Sa i përket cilësisë së vetë Hoxhës, e njoh që kur luante për Ballkanin. Atje ai tregoi potencial të madh dhe premtoi se do të shndërrohej në një lojtar të madh", ka thënë Kozniku në një intervistë për "index.hr". "Nuk e kam të qartë pse ai nuk pati një shans te Lokomotiva, sepse dominoi në ligën e Kosovës dhe me bashkëlojtarë më të mirë mund të jetë vetëm më i mirë. Cilësia e tij nuk vihet aspak në dyshim dhe sigurisht që Dinamo nuk e ka njohur rastësisht dhe e ka sjellë. Slaven duhet përgëzuar që

e solli dhe i dha një shans. Tani e ka shpërblyer. Hoxhës i uroj vetëm më të mirat dhe ta tregojë potencialin në Dinamo", ka shtuar ai.

"Jam i sigurt se ai mund të japë ndeshje shumë të mira për Dinamon. Është vetëm çështje që ai të përshtatet dhe të jetë në formë. Është ndryshe të luash në Slaven sesa në Dinamo apo Hajduk, që janë klubet tona më të mëdha dhe kur je çdo ditë nën llupë. Duhet të jesh vazhdimisht i mirë dhe besoj se ai mund ta bëjë këtë dhe duhet të mësohet me faktin se do të jetë një nga lojtarët e Dinamos, ndërsa te Slaven gjithçka kaloi përmes tij", ka deklaruar Kozniku, i cili më pas ka theksuar se përmes Dinamos mund të marrë thirrje si nga kombëtarja e Kosovës ashtu edhe nga Shqipëria, varësisht kush, sipas tij, do ta thërrasë. "Por, e përsëris, cilësia është aty dhe nuk kam frikë për të. Është mirë edhe për kombëtaren e Kosovës apo Shqipërisë, varësisht se kush do ta thërrasë, sepse besoj se përmes Dinamos mund të



meritojë thirrje dhe ndihmë me cilësinë e tij. Ai tregon cilësi shumë të mira të një lojtari modern pasi ka një këmbë të fortë të majtë dhe të djathtë dhe driblime dhe rishikim të shkëlqyer të lojës", vuri në pah Kozniku.

Ish-futbollisti foli edhe për lojtarët e rinj që janë duke ardhur në Kroaci nga Kosova duke thënë se klubet e Kosovës



janë duke punuar seriozisht. "Nga atje erdhën vërtet shumë lojtarë të mirë, veçanërisht nëse kemi parasysh që territori është kaq i vogël. Edhe në ligën e ish-Jugosllavisë kishte shumë lojtarë të mirë, edhe pse kushtet për zhvillim ishin prapa në krahasim me vendet e tjera. Por nuk është si më parë, sepse tani Kosova po punon shumë seriozisht, dhe klubet po bëjnë rrugën drejt

Evropës", theksoi Kozniku. "Kushtet e punës janë përmirësuar shumë vitet e fundit dhe puna është e mirë edhe në kombëtare, sepse lojtarët më të rinj monitorohen më mirë. Shembulli më i mirë është Ballkani, i cili munda Dinamon këtë sezon. Për mua është normale që klubet kroate të shikojnë gjithnjë e më shumë poshtë, sepse lojtarët janë të talentuar dhe cilësorë, dhe ende nuk janë aq të shtrenjtë sa të mos jenë të disponueshëm për klubet tona". "Para disa vjetësh organizova një kamp me Lokomotivën në qytetin tim të lindjes në Gjakovë, dhe atje kishte aq shumë talentë saqë, po të isha menaxher, do të mbushja çdo ditë një autobus me lojtarë që mendoj se janë të mirë dhe mund të bëjnë një karrierë. Është marrëzi të thuash se këta janë djem të uritur por, mbi të gjitha, janë të uritur për sukses. Të gjithë ata që kam takuar dallohen për të qenë shumë të ndershëm, punëtorë dhe kanë qëndrimin e duhur ndaj futbollit dhe jetës", ka thënë Kozniku.

Batatina refuzon tri oferta nga Evropa



PODUJEVË, 10 JANAR - Tahir Batatina do t'i qëndrojë besnik Llapit, edhe pse kishte oferta zyrtare në drejtim të tij kohën e fundit. Trajneri llapjan ka qenë mysafir në emisionin "Reload" në RTV Dukagjini, ku ka folur për karrierën e tij. Ndër të tjera, i pari i shtabit teknik të Llapit ka bërë me dije se kishte oferta zyrtare nga Astana dhe Sheriff

Tiraspol si dhe një tjetër nga një klub azer, por që i ka refuzuar ato. "Kam pasur oferta nga Kazakistani ku ishte Astana, nga Azerbajxhani, por edhe nga Moldavia, ku më kërkoi gjiganti Sheriff Tiraspol. Kanë qenë oferta të mira, pasi e Sheriffit ishte 330 mijë euro në vit, por kam vendosur t'i refuzoj shkak të Llapit ku dua

të dal kampion", ka thënë Batatina. 43-vjeçari e ka udhëhequr Llapin që nga viti 2013 deri më 2018, ku për një kohë u largua nga pozita e trajnerit për të kryer atë të drejtorit sportiv. Megjithatë, nga viti 2019 ai është rikthyer në krye të Llapit dhe ka kontratë me klubin deri në qershor të vitit 2024.

Muja: Prishtina në pranverë do të jetë më e fuqishme

PRISHTINË, 10 JANAR - Ardian Muja në stinorin vjeshtor ka nisur të gjitha ndeshjet si titullar, 19 sosh, si mbrojtës i majtë, duke llogaritur edhe ndeshjen e Kupës, duke regjistruar më së shumti minuta, 1 656, duke realizuar 1

gol dhe duke i prirë edhe me tre me futbollistë të tjerë listës së asistimeve me 3 sosh. "Jam shumë i kënaqur me përgatitjet që jemi duke i bërë dhe të cilat nuk i kemi ndërprerë fare, me vetëm pushime të shkurtra, po ashtu shpresoj të kemi edhe sa

më pak lëndime, sepse në vjeshtë ato na kanë penalizuar shumë, megjithëse tani shumica nga ata futbollistë janë rikthyer dhe me ta do të jemi edhe më të fortë", ka thënë Muja. "Edhe pse pozita e mbrojtësit të majtë për mua është panatyrshme,

mendoj se kam dhënë maksimumin, sikurse edhe tërë ekipi që me gjithë ato lëshime pikësh të ndodhemi lart në pozicionim dhe afër objektivave që kemi. Në pranverë jam i bindur që do ta shohim Prishtinën krejt ndryshe, të



fuqishme dhe në luftë dhe të rreptë për vetë kreun e tabelës", ka shtuar Muja.

Pochettino: Nuk kemi nevojë për sulmues, kemi Brojën

Londër, 10 janar - Trajneri i Chelseat, Mauricio Pochettino, ka thënë se ka zhvilluar bisedime me pronarët e klubit për të diskutuar në lidhje me merkaton e janarit. “Ne po vlerësojmë skuadrën aktuale si gjithmonë. Ne patëm një bisedë

me pronarët dhe drejtorin sportiv. Ne po kërkojmë, ashtu si edhe ekipet e tjera, mundësitë që do të ofrojë merkato e janarit. Gjithçka shkoi mirë në këto takime. Ne mbajmë gjithmonë një marrëdhënie të mirë”, ka thënë Pochettino.

Me Christopher Nkunku të lënduar përsëri dhe Nicolas Jacksonin të larguar në Kupën e Kombeve të Afrikës, Pochettino hodhi poshtë sugjerimet që Chelsea duhet të nënshkruajë me një sulmues. “Jam shumë i lumtur sepse kemi Armando

Brojën dhe Cole Palmer që mund të luajnë në pozicionin e sulmuesit. Ne kemi nevojë për linjën tonë të dytë të lojtarëve sulmues për t’u rritur dhe për të shënuar gola. Unë jam shumë pozitiv dhe i lumtur me skuadrën”, ka shtuar Pochettino.



Asani: U shënojnë të gjitha ekipeve në Evropian

PRISHTINË, 10 JANAR - Futbollisti i Kombëtares së Shqipërisë, Jasir Asani, në një rrëfim ndryshe për “Klan Maqedonia”, flet për ndjenjat dhe emocionet e forta që ka përjetuar gjatë karrierës së tij. Asani tregon se të qenit pjesë e Kombëtares së Shqipërisë është një ëndërr e plotësuar që kur ishte fëmijë. Ai tregon si ka pritur thirrjen e parë nga trajneri Silvinjo, tregoi emocionet dhe parashikimet e tij për grupin e “ferrit” të kuqezinjve në “Euro 2024” në Gjermani, si dhe ku ka dëshirë ta mbyllë karrierën si futbollist. “Kur ftesa erdhi isha në Korenë e Jugut dhe dy ditë para, normalisht, nga gëzimi edhe qan dhe bën të pamundurën për çdo gjë, sepse po të plotësohet dëshira që nga fëmijëria që e ke pasur për Kombëtaren e Shqipërisë. Është një emocion i paparë, sepse të vjen koha që ti të luash për atë fanellë shumë të rëndë, shumë emocion që të jep dhe me ata tifozë anembanë botës që vijnë e të mbështesin. Sidomos në ‘Air Albania’, që kanë qenë ato tri ndeshjet më të vështira, me Poloninë, Moldavinë dhe Çekinë



që kemi fituar. Nuk mund ta përshkruash me fjalë, e paparë”, u shpreh ylli i Kombëtares shqiptare, Jasir Asani. I pyetur për grupin e shumëdiskutuar, i njohur ndryshe si grupi i “ferrit”, ku Shqipëria është bashkë me kombëtare si: Italia, Kroacia dhe Spanja, Asani duket mjaft optimist dhe me entuziazëm thotë se të gjithë ekipeve do t’u shënojnë gol. Ai, gjithashtu, shpreson se do të arrijnë ta kalojnë grupin. “Doja një grup shumë të fortë, si ky që kemi, në mënyrë që

ta shohim veten ku jemi dhe t’i tregojmë gjithë botës se nuk jemi rastësisht në Gjermani. Nuk ka qenë rastësi që kemi mundur Poloninë, Çekinë, Moldavinë. Është mirë që e mbyllëm në vend të parë dhe unë mendoj se do të bëjmë gjëra të mëdha pa marrë parasysh se çfarë ekipi do të kemi aty”, ka thënë Asani i cili dëshiron që karrierën ta mbyllë te Partizani: “Karrierën dua ta mbyll te Partizani, pasi atje është familja ime e dytë”.

Lakersat triumfojnë në sekondat e fundit, Minnesota ruan kreun në Perëndim



LOS ANXHELOS, 10 JANAR - Lakersat fituan në sekondat e fundit me rezultat 132-131 ndaj Torontos në një ndeshje spektakolare, duke korrur suksesin e dytë radhazi. Një mbrëmje magjike e Anthony Davisit, autor i 41 pikëve e 11

reboundeve, mbështetur nga LeBron Jamesi me 22 pikë e 12 asistime. Në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit qëndron Minnesota, që mundi me rezultat 113-92 Orlando. Towns me 28 pikë ishte shënuesi më i mirë për

miqtë. Fiton edhe Sacramento, që falë “triple double” (37 pikë, 10 rebounde, 13 asiste) të Sabonis, mundi me rezultat 131-110 Detroitin. Fitorja e tretë radhazi për Memphisin, që mundi me rezultat 120-103 Dallasin në shtëpinë e këtij të fundit. Bane me 32 pikë bëri dallimin në fushë, ndërsa 43 pikë erdhën nga lojtarët e stolit. New York mposhti Portlandin (113-84), ndeshje ku u dallua Anuoybu me 23 pikë.

REZULTATET

Detroit - Sacramento	110-131
Orlando - Minnesota	92-113
New York - Portland	112-84
Dallas - Memphis	103-120
Lakers - Toronto	132-131

Pique fillon karrierën si trajner

Një vit pas daljes në pension si lojtar, Gerard Pique do ta bëjë së shpejti debutimin e tij si trajner në një projekt të ri që do ta ketë

atë si udhërrëfyes teknik. Ish-mbrojtësi i Barcelonës, i cili vari këpucët e tij në janar të vitit 2023, e bëri me dije vetë duke postuar

një mesazh në llogarinë e tij X, duke specifikuar se do të bëhej trajner. “Një vit i ri ka filluar dhe pas vlerësimit të kujdesshëm

kam vendosur të kthehem në futbollin. Më mungon shumë. Kësaj radhe nuk do të jetë si lojtar. Do të jetë si trajner. Më

shumë detaje do t’ju jap në fund të javës”, ka shkruar spanjoli, i cili së shpejti do ta festojë 37-vjetorin e lindjes.

SHKURT

Nëse dështon transferimi i Mbappes, Reali synon Musialan

Real Madridi ka hyrë sërish në garë për shërbimet e Kylian Mbappes, i cili ka kontratë me Paris Saint-Germainin deri në fund të këtij edicioni. Por, madriten duket se kanë mësuar nga herët e kaluara dhe tash duan të jenë më të sigurt. Si pasojë e kësaj, ekipi spanjoll ka gjetur zëvendësuesin e Mbappes në rast se dështon sërish pista me të. Jamal Musiala është njëri që mund të zbarkojë në “Santiago Bernabeo”. Musiala është bërë një lojtar kyç i ekipit të parë për Bayernin e Munichut që nga debutimi i tij në vitin 2020, duke shënuar 36 gola dhe duke dhënë 26 asistime në 143 ndeshje në të gjitha kompeticionet.

Tost: Çdo pilot që është me Verstappenin do të konsiderohet pilot i dytë

“Nëse Max do të ketë një makinë të mirë do të vazhdojë të fitojë të tjera gara dhe tituj në Formula 1. Nuk është ende në kulmin e karrierës së tij. Çdo pilot që është apo do të jetë shok skuadre me të do të konsiderohet numri 2 në atë skuadër”.

I këtij mendimi është Francz Tost, ish-drejtues i skuadrave të Formula 1. Ishte pikërisht Tost që solli për herë të parë Max Verstappenin në Formula 1 në vitin 2015, kur asokohe provoi dhe debutoi me makinën Toro Rosso. “Mendoj se Max është një pilot të cilit mund t’i besosh gjithçka në garë, ashtu sikurse mund t’i besoj Michael Schumacherit apo Sebastian Vettelit. Është një pilot i kompletuar dhe do të duhet shumë punë për rivalët që ta zbresin nga podiumi”, ka deklaruar Tost.

Presidenti i PSG-së akuzon Messin: Nuk tregoi respekt për klubin

Lionel Messi u largua nga Paris Saint-Germaini gjatë verës së vitit të kaluar pa arritur të linte gjurmë. Madje ylli argjentinas u largua prej Parisit në mënyrën më të keqe të mundshme. Ai u kontestua nga tifozët, të cilët nuk ishin të kënaqur me paraqitjet e tij. Madje ata e kishin fyer 36-vjeçarin dhe e kishin vërshëlyer. Dhe, kur u largua nga “Parku i Princave”, Messi nuk tregoi respekt për parisienët dhe nuk i përmendi askund. “Nëse dikush flet keq për PSG-në pas largimit, kjo nuk është e mirë. Ky nuk është respekt”, ka deklaruar Al-Khelaifi. Messi i kaloi dy vjet në PSG, ku ishte transferuar si lojtar i lirë. Më pas, gjatë verës, iu bashkua Inter Miamit, duke i dhënë fund përvojës evropiane.

Unitedi huazon Sanchon në Dortmund

Jadon Sancho do të luajë prapë në Bundesligë. Futbollisti anglez do ta kalojë së paku pjesën e dytë të sezonit 2023/24 në kampionatin gjerman. Manchester Unitedi dhe Borussia Dortmundi kanë arritur marrëveshje për huazimin e lojtarit në Gjermani, por pa mundësi të blerjes definitive të kartonit të tij nga ana e klubit verdhezi. Mësohet se përfaqësuesi anglez do të udhëtojë sot drejt Gjermanisë për t’i kryer vizitat mjekësore. Dortmundi do të bëhet pjesë e rrogës së lojtarit, ndërsa do t’i paguajë 4 milionë euro për gjashtë muaj. Sancho kishte shkëlqyer në përvojën e tij të parë në Gjermani, por në “Old Trafford” nuk arriti të linte gjurmë.

Njoftim për shuarje të biznesit “Nik & F98 Group”, Sh.P.K

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Nik & F98 Group”, Sh.P.K, me seli në Prizren, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 812099978 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore – Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Nik & F98 Group”, d.o.o., od Prizren, donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 812099978 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that “Nik & F98 Group”, L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: 812099978, from Prizren, has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Njoftim për shuarje të biznesit “REKLAMOJE”, Sh.P.K

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Reklamoje”, Sh.P.K, me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 811361807 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore – Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

